

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

Numri rendor	Data e regjistrimit të kërkesave	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Statusi i kërkesës	Tarifa në lekë
1	03.01.2018	Jam perfaqësuesja ligjore e nje kontrate porosie me shoq "Beu Konstruksion" dhe dua informacion per kete shoq dhe per asetet e saj qe jane bllokuar	03.01.2018 Përsëndetje Në përgjigje të e-mailit tuaj ju bëjmë me dije se, për të marrë informacion në lidhje me shoqërinë ” Beu Konstruksion” për asetet e bllokuara të kësaj shoqërie, ju mund të tërhiqni ekstrakt pranë sporteleve të Qendrës Kombëtare të Biznesit ose mund ta merrni atë nëpërmjet lëshimit të ekstrakteve në format elektronik. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
2	03.01.2018	Pershendetje, Doja te me ndihmonit me informacion se cfare dokumentash duhen per te paraqitur per shitjen e kuotave te nje biznesi.	03.01.2018 Bashkelidhur po ju dergojme dokumentacionin e kerkuar nga ana juaj. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
3	03.01.2018	Pershendetje, Subjekti Shkelqim Sufaj me nipt L12206501V eshte regjistruar si person fizik me TVSH dhe Tatim Fitim. Duam te dime : 1.A mund te nderrojme formen juridike nga person fizik ne person juridik me te njejtin Nipt?	03.01.2018 Përsëndetje Në përgjigje të e-mailit tuaj, ju sqarojmë si vijon: Ligji 9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, nuk parashikon kalimin e subjekteve nga person fizik, në person juridik. Mbështetur në nenin 60 të ligjit të sipërcituar, Numri unik i identifikimit të subjektit jepet vetëm një herë, në çastin e regjistrimit fillestar dhe është i pandryshueshëm, si dhe nuk u jepet subjekteve të tjera edhe pas çregjistrimit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

4	03.01.2018	Pershendetje a mund te kryhet onlne procesi i perditimit te te dhenave te biznesit me NID nese po si	03.01.2018 Pershendetje, Lidhur me kerkesen e ngritur ju njoftojme qe perditimi i te dhenave te nje subjekti kryhet vetem prane sporteleve te QKB-se. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
5	03.01.2018	Pershendetje, Per sa citoni per refuzimin e aplikimit tone CN-604095-12-17, ju informoj qe autorizimi per aplikimin eshte leshuar nga presidenti (ortaku i vetem i shoqerise) , pasi zgjatja e afatit te administratorit ne rrethana ku shoqeria do te kaloje ne stad pezullimi do te ishte pa sens.	04.01.2018 Përsëndetje, Në përgjigje të e-mailit tuaj ju sqarojmë si më poshtë vijon: Nga verifikimi i kryer në regjistrin tregtar rezulton se, më datë 22.12.2017, është kryer aplikimi me numër çështje Cn-604095-12-17, për pezullim aktiviteti nga shoqëria "TOT-Trading in Oil & Transport" me numër NUIS (NIPT) K82005016, aplikim i cili është refuzuar me arsyen se "Në bazë të nenit 26/3 të ligjit Nr.9723, mungon autorizimi nga administratori për aplikantin (Administratorit të shoqërisë i ka mbaruar afati i qëndrimit në detyrë.) Në lidhje me pretendimin tuaj se autorizimi për aplikimin me numër çështje CN-604095-12-17, është nënshkruar nga ortaku i shoqërisë ju bëjmë me dije se në mbështetje të nenit 26, pika 3 e ligjit 9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar,Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre." Për sa më sipër ju sqarojmë se, autorizimin që do paraqitni pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit duhet të nënshkruhet nga administratori i shoqërisë "TOT-Trading in Oil & Transport". Duke qënë se administratorit të shoqërisë së sipërcituar i ka mbaruar afati i qëndrimit në detyrë, duhet të paraqiteni pranë QKB-së të kryeni aplikim për zgjatje të afatit të administratorit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

6	03.01.2018	Pershendetje! Jam nje individ qe para disa kohesh kam pasur nje biznes te regjistruar ne emrin tim. Me pas kam bere kerkese per falimentim te cilat i kam plotesuar ne zyrat tuaja. Per shkak te disa angazhimeve te tjera nuk kam mundur te vazhdoj procedurat e tjera. Ajo c'ka doja te pyesja eshte: 1- C'fare me duhet te bej? 2- A jam debitor ne shtet ose a jam i gjobitur?	04.01.2018 Përsëhëndetje Në përgjigje të e-mailit tuaj ju sqarojmë si më poshtë vijon: Nga verifikimi i kryer në regjistrin tregtar rezulton se, është kryer aplikim më datë 21.12.2015, me numër çështje CN-467285-12-15, për çregjistrim biznesi, i cili është refuzuar me arsyen se: <i>Çështja refuzohet, pasi sipas shkresës nr.8214/1 – 8248/1 Prot., datë 26.01.2016, ardhur nga Bashkia Tiranë, subjekti ka detyrime të pashlyera/gjoba apo interesa të papaguara me vlerë 35000lekë.</i> Për sa më sipër ju bëjmë me dije se, duke qënë se aplikimi që keni kryer më datë 21.12.2015, është refuzuar ju duhet të kryeni një aplikim të ri për çregjistrim biznesi, ndërkohë duhet që të shlyeni të gjitha detyrimet që keni ndaj organeve tatimore. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
7	04.01.2018	Pershendetje , Uroj te jeni mire, Doja nje informacion per nje situatë te tille, kam patur nje NIPT /biznes per te cilin kam kryer kerkese per cregjistrim por nuk eshte cregjistruar akoma pasi kam patur gjoba.Dua te rinis aktivitetin privat por me te njejtin NIPT numer , duke paguar dhe gjobat nderkohe. A mund ta perdor te njejtin numer nipti?	05.01.2018 Pershendetje, Lidhur me kerkesen tuaj ju bejme me dije se, kerkesa juaj per cregjistrim eshte refuzuar, bashkelidhur po ju dergojme vendimin e refuzimit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

8	05.01.2018	si eshte e mundur qe nga ju behet regjistrimi fillestare dhe po nga ju meret nje certifikate cregjistrimi dhe po nga ju nuk nihat si e tille	05.01.2018 Përshëndetje, Nga verifikimi në regjistrin tregtar, rezulton se QKB më datë 28.03.2017, ka miratuar çështjen me nr. CN-773797-12-14, duke kryer çregjistrimin e subjektit Bledar Lleshi, me NUIS(NIPT) L37104401O. Një fakt i tillë rezulton edhe në ekstraktin historik, të subjektit tregtar, person fizik Bledar Lleshi, me NUIS(NIPT) L37104401O, informacion i cili është i aksesueshëm edhe në faqen zyrtare të QKB-së, www.qkr.gov.al	Perfunduar	Nuk ka
9	05.01.2018	ekstrat i Camera di Commercio Industria Artigianato e Agricoltura di Firenze , duhet te jete patjeter me vule apostile apo nuk eshte nevoja ?	05.01.2018 Përshëndetje Në lidhje me pyetjen tuaj ju informojmë si më poshtë vijon: Shqipëria është anëtare e Konventës së Hagës “Për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve zyrtare të huaja” të 5 tetorit 1961, që do të thotë se dokumentet shqiptare që do të përdoren në vendet anëtare të së njëjtës Konventë, si dhe anasjelltas, nuk do të legalizohen nga përfaqësitë diplomatike e konsullore. Në bazë të kësaj Konvente, dokumentet pajisen me një vulë Apostille nga autoriteti kompetent i vendit ku janë lëshuar dhe më pas mund të përdoren direkt në institucionin përkatës të vendit pritës.	Perfunduar	Nuk ka
10	05.01.2018	jam punonjes i taksave bashkia Kavajë dhe interesohem per firmat qe ushtrojne aktivitet ne zonen helmas	08.01.2018 Pershendetje,Informacioni mujor i cili permban dokumentet mbi regjistrimet e reja, ndryshimet apo crregjistrimet ne te gjitha bashkine e kavajes, ju eshte derguar me e-mail ne date 5.1.2017.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

11	05.01.2018	Pershendetje. kerkoj informacion shtese lidhur me pezullimin e aplikimit per projekt bashkimin e shoqerive me pergjegjesi te kufizuar.ceshtja nr CN-605465-12-17 pasi ne arsyet e pezullimit shkruhet "Te saktësohet data ne te dyja vendimet pika 3 data e bashkimit) sqaroj se ne vendimet e paraqitura nga ana e shoqerise tone eshte shprehur shume qart data 31/12/2016 .	09.01.2018 Në mbështetje të nenit 216, pikës 3 të ligjit 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, çdo shoqëri që merr pjesë në bashkim jo më vonë se një muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë , për vendimin e përcaktuar në nenin 218 të këtij ligji , depoziton pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe publikon në faqen e internetit të shoqërisë, nëse ka , projekt-marrveshjen dhe raportin e bashkimit, sipas pikës 2 të këtij neni. Pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë e dokumentet publikohen në mënyrë të detyrueshme për të paktën tri vitet e fundit. Referuar më sipër, në lidhje me pretendimin tuaj se nga ana e shoqërisë suaj është shprehur shumë qartë data e momentit të bashkimit të shoqërive, ju bëjmë me dije se, data që ju keni paraqitur në vendimet e asamblesë, për regjistrim pranë QKB-së është 31.12.2016 , ndërkohë që duhet të saktësohet data dhe viti duhet të jetë 2018 .	perfunduar	Nuk ka
12	08.01.2018	pershendetje, ju lutem mund te me beni me dije aresyen qe nuk eshte mbyllur ende ceshtje me nr CN-595834-12-17 FALEMINDERIT	09.01.2018 Pershendetje, Lidhur me kerkesen tuaj ju bejme me dije se, aplikimi juaj me numer CN-595834-12-17, pas shqytimit eshte refuzuar, bashkelidhur po ju dergojme vendimin e refuzimit.	Perfunduar	Nuk ka
13	08.01.2018	Pershendetje, Une jam Adriana Hysen-likujdatore e shoqerise: Lion Travel me nipt L71921006Q. Shoqeria e ka mbushur afatin perfundimtar te parashikuar nga ligji per tu cregjistruar por deri me sot QKB nuk ka bere cregjistrimin. Ju lutem te meren masat Ju faleminderit	09.01.2018 Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se, aplikimi për çregjistrim i kryer për subjektin me NUIS (NIPT) L71921006Q është miratuar. Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al . Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

14	08.01.2018	Pershendetje, Ju bejme me dije se kemi bere kerkesen per crregjistrim per subjektin Sabri Kalemi(i cili nuk jeton me) dhe nuk kemi marre akoma nje pergjigje.CN-515137-10-17 L62011501A Armand Kalemi	09.01.2018 Pershendetje Lidhur me kerkesen tuaj ju bejme me dije se, aplikimi me numer ceshtje, CN-515137-10-17, eshte refuzuar. Bashkelidhur po ju dergojme vendimin e refuzimit. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
15	08.01.2018	Ju lutem te me informoni nqs kerkesa e bere nga Rozafa shpk per nje Licence (aplikim I dates 20.12.2017) eshte autorizuar nga ana juaj. Dje kam marre lajmerim qe nga Ministria e Bujqesise (AKU) ka dale me sukses si ceshtje! Kur mund te jete gati nga ana e QKB?	09.01.2018 Pershendetje, Lidhur me email-in e paraqitur nga ana juaj, ju sqarojmë si më poshte vijon: Nga kontrolli i të dhënave të publikuara në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve rezulton se aplikimi me LC-5809-12-2017 i subjektit “ROZAFa”, me NUIS/NIPT K48130547V është me status aktiv (numri i licencës është LN-4306-01-2018) Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
16	09.01.2018	Pershendetje!Shoqeria T-Square Cosmetics me Nipt: L63223601E per arsye te mos dergimit te pasqyrave financiare te vitit 2016 ne QKB pranon pagesen e penalitetit sipas udhezimeve tuaj por fatura eshkarkuar nga portal E-Albania eshte epamundut per pagese ne banke duke na dhene pergjigjen se ky kod insitucioni nuk ekzistone systemine bankes	10.01.2018 Pershendetje, Bashkelidhur po ju dergojme faturen per arketim me kodin aktual te institucionit. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

17	10.01.2018	Pershendetje si mund te sigurohem nese subjekti me Nr NIPT L52704201M ka leje mjedisi	10.01.2018 Pershendetje, Lidhur me email-in e paraqitur nga ana juaj, ju sqarojmë si më poshte vijon: Nga kontrolli i të dhënave të publikuara në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve rezulton se subjektit “Raimonda Ropi”, me NUIS/NIPT L52704201M nuk është pajisur me leje mjedisi. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
18	10.01.2018	Pershendetje! Me shkresen nr.2694 prot, dt.21.12.2017, kemi kerkuar prane QKB venie sekuestro mbi aksionet e subjektit Edmond Kaso me NUIS K32514739H, gjate verifikimeve tona ne ekstraktin historik vume re qe nuk eshte vendosur masa e sekuestros.	10.01.2018 Përsëhëndetje, Ju bëjmë me dije se, me aplikimin me numër CN-614900-01-18, datë 10.01.2017 është kryer depozitim i Urdhrit Nr.2694Prot, datë 21.12.2017, protokolluar nga QKB me Nr. 17778 Prot., date 28.12.2017 "Për Vendosjen e Sekuestros Konservative", lëshuar nga Shoqeria Permbarimore “Studio Pema”, drejtuar QKB, ku është urdhëruar: Venia e masës së sekuestros konservative mbi çdo aksion të debitorit Edmond Kaso me NIPT-K32514739H dhe të behet bllokimi me qellim mostjetersimin e tyre, per tu shmangur nga detyrimi per ekzekutimin e titullit ekzekutiv.	Perfunduar	Nuk ka
19	11.01.2018	Pershendetje. Ne lidhje me aplikimin me nr 619495 per rregjistrimin e firmes Info Tech, mora pergjigje qe nuk mund te rregjistrohet sepse eshte “emer i ngjashem”. Emri i firmes qe duhet te rregjistrohet eshte me dy fjale te ndara dhe me hapesire ne mes (Info Tech) qe rezulton i lire ... ju lutem me ndihmoni te me shpjegoni se cfare gabimi ka dhe si mund ta rregulloj.	11.01.2018 Në lidhje me kerkesen tuaj se emri i shoqërisë që duhet të regjistrohet është me dy fjalë te ndara dhe me hapesirë në mes, ju bëjmë me dije se, karakteret e vëna në emrin e subjektit që ju kërkoni të regjistroni nuk përbëjnë dallim. Për sa më sipër nga të dhënat në regjistrin tregtar rezulton se emri që ju kerkoni të regjistroni është i njëjtë me subjektin infotech që figuron i regjistruar	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

20	11.01.2018	Pershendetje, Duke ju referuar statusit aktual te kerkeses per pajisje me leje mjedisore tipi B per Subjektin: ALMARINA OR L56506204C, LC-2876-07-2017 PN-5926-10-2017 me status aktual -Aprovuar -Institucioni tjeter - Pergatitja e Titullit, Kerkojme nga ana juaj te na jepni nje zgjidhje per terheqjen e kesaj leje pasi kane kaluar disa muaj nga momenti i aplikimit.	11.01.2018 Pershendetje, Ju bejme me dije se kerkesen tuaj ia kemi percjelle Ministrise se Mjedisit. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
21	11.01.2018	Pershendetje, Do ju lutesha ne mirekuptimin tuaj per te pare pak me prioritet aplikimin e shoqerise Besa Agro Invest Shpk per regjistrimin e ndryshimit te Administratorit te shoqerise pasi na jane penguar nga ana e Bankes te gjitha veprimet deri ne regjistrimin e vendimit ne QKB.Lutemi ne mirekuptimin tuaj pasi kemi te gjitha punetoret pa paguar. Numri I aplikimit CN-611556-12-17.	11.01.2018 Përsëhëndetje, Ju bëjmë me dije se aplikimi me numër CN-611556-12-17 është miratuar. Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
22	11.01.2018	Pershendetje! Kemi aplikuar per heqje barre siguruse nga Tatimet me nr aplikimi CN-603550-12-17 dt 22/12/2017,Na kerkuan depozitimin e Balanceve te viteve 2013-2014 si dhe emerim administratori me nje afat te caktuar	11.01.2018 Përsëhëndetje,Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-603550-12-17 është miratuar.Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
23	12.01.2018	Pershendetje. Ne jemi nje brend i cili merret me prodhimin dhe shitjen e sobave me peleta. Jemi te interesuar te kemi partneret tane shites ne Shqiperi. A mund te	15.01.2018 Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

		na dergoni nje liste te plote te bizneseve te cilat merren me shitje te artikujve elektrik apo teknike te bardhe	Me qëllim shkurtimein e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individ/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave. Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).		
24	13.01.2018	We would like to update our contact information, which is incorrect. Is that possible online? Our company is Bote Farms (ID -L74819801R) and our temporary representative set up the registration for us but it currently has his email address os contact instead of ours. As he was just our representative to set up the business further contact should be made directly to us. Can this be done remotely or must we go into the office	15.01.2018 Dear Mr. Drevlo, Regarding on your request,we would like to inform you that in order for the update of the data stipulated in your email, which are registered at the commercial register, the administrator (legal representative) of the company must submit the request at the service window of the NBC, either located at the headquarters of the NBC or at the governmental portal e-Albania (www.e-albania.al)	Perfunduar	Nuk ka
25	15.01.2018	Pershendetje,Euro Asia Footwear ka bere nje plotesim dokumentacioni per ceshtjen CN-606675-12-17 duke paguar penalitetin 15000ALL.Doja te pyesja a mund te marr sot ekstraktin e shoqerise me ndryshimin se duhet derguar ne dogane .	15.01.2018 Përshëndetje,Ju bëjmë me dije se aplikimi me numër CN-606675-12-17 është miratuar. Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al . Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
26	15.01.2018	Pershendetje! Me date 06.11.2017, eshte aplikuar prane QKB me nr ceshtje CN-548228-11-17, per c'regjistrimin e personit fizik Rina Saliaj, me nr Nipti L41306068B, dhe ende statusi i aplikimit eshte c'regjistrim ne pritje DPT, pavaresisht faktit qe subjekti nuk ka detyrime te papaguara dhe jane	15.01.2018 Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-548228-11-17 është miratuar dhe subjekti aktualisht figuron me status çregjistruar.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

		tejkualuar te gjitha afatet ligjore per perfundimin e nje procedure te tille.	Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al . Faleminderit		
27	15.01.2018	Une jam Abdulla Hysenagolli, pare reth nje muaji kam bere nje aplikim per mbyllje biznesi me NIPT K81511050K por deri ne keto momente nuk ka marre asnje pergjigje se cfare ka ndodhur me kerkesen time.	15.01.2018 Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se, subjekti me NUIS (NIPT) K81511050K është çregjistruar. Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al . Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
28	15.01.2018	Ju lutem, me anë të këtij emaili dëshiroj të informohem lidhur me Statusin e Aplikimit mbi regjistrimin fillestar te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “FIN Invest”	15.01.2018 Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-623528-01-18 është miratuar. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

29	15.01.2018	Mund te na informoni lidhur me proceduren qe duhet te ndjekim per te filluar eksport importin.(A lejohet fillimisht qe me te njeitin nipt te operojm dhe me pjesen tjeter dhe cfare dokumentash shtes duhen ne menyre qe te mos kemi pengsa ne dogane?)	16.01.2018 Përshëndetje Në përgjigje të e-mailit tuaj ju informojmë si më poshtë vijon: Mbështetur në nenin 43 të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, çdo subjekt , që kryen regjistrimin fillestar, mbart edhe detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistër. Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se ju duhet të kryeni aplikim për shtim objekti të veprimtarisë së shoqërisë, pranë sporteleve të Qendrës Kombëtare të Biznesit, duke paraqitur vendimin e ortakut të vetëm dhe autorizimin në qoftë se aplikimin nuk e kryen vet administratori	Perfunduar	Nuk ka
30	15.01.2018	Good afternoon, I have a question regarding how to view the business-sheets for a company registered in Albania. I was able to locate and download the historical extract with all the information. Is it possible to obtain and download the balance-sheets as well? Thank you for your help,	16.01.2018 Dear Sir/Madam, Regarding your question we would like to inform that you can find the needed information inside the historical extract named “APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE”. Attached you find one example as these balance-sheets are included and are part of the Extract, when they are presented	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

31	15.01.2018	Dear Sir or Madam, Thank you very much for your quick answer. Although it is not a website of your QKB, may I also ask you for the website of TEDA (Technology and Economic Development Zone)? I found several times the address "teda.gov.al" but this does not work. Do you know any contact details of a person who can help with this problem	16.01.2018 Dear Ms. Hemken, You can contact the address www.aida.gov.al (Albanian Investment Development Agency) for further information regarding doing business in Albania. Best regards,	Perfunduar	Nuk ka
32	15.01.2018	Pershendetje, Ju lutem te mund te me ndihmoni me pajisjen e nje vertetimi per egzistencen time si adminsitratore e shoqerise Ente Fiera sh.a. me numer NIPT L02207016T	16.01.2018 Përshëndetje Në përgjigje të e-mailit tuaj ju informojmë si më poshtë vijon: Nga verifikimi i kryer në regjistrin tregtar rezulton se informacioni që ju kërkoni në lidhje me ekzistencen tuaj si administratore e shoqërisë “Ente Fiera” Sh.a, gjendet në aktet e depozituara pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, konkretisht në aktin e themelimit.	Perfunduar	Nuk ka
33	16.01.2018	Pershendetje, Bashkelidhur po ju dergoje formularin e ankeses ne lidhje me nje cregjistrim. faleminderit	17.01.2018 Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se, aplikimi për çregjistrim i kryer për subjektin me NUIS (NIPT) K77014001R u miratua dhe subjekti aktualisht figuron me status: çregjistruar.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

34	16.01.2018	Pershendetje! Per te hapur nje filjal ne tirane te nje kompanie ne Londer, eshte e nevojshme qe perkthimi i akti i themelimit te behet nga nje noter ne shqiperi apo eshte funksionale nje perkthim i bere ne Londer	17.01.2018 Në lidhje me pyetjen tuaj ju informojmë se, përkthimi i aktit të themelimit mund të bëhet nga një noter në Shqipëri, në qoftë se përkthimi i aktit kryhet jashtë territorit të shqipërise atëherë duhet patjetër të legalizohet në bazë të marrëveshjeve në fuqi.	Perfunduar	Nuk ka
35	16.01.2018	Përsëhendetje, Në kuadër të projektit " Deputeti im' (www.deputetim.al) me mbështetjen e Qeverisë së Mbretërisë së Holandës, Instituti i Studimeve Politike është duke monitoruar deputetet dhe institucionin e Kuvendit të Shqipërisë. Në funksion të këtij projekti dhe në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit ju drejtohem i këtë kërkesë për informacion.	25.01.2018 Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi. Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individ/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave. Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).	Perfunduar	Nuk ka
36	17.01.2018	Jam Shqiponja Burnazi dhe kam hapur ne 2008 nje license me nipt K81408021C qe me kushtoi shume sepse nuk e perdora fare per aresye shendetesore. kam aplikuar prane jush se fundmi me çeshtjen nr. CN-389036-07-17 dhe me beni refuzim per aresye te detyrimit ndaj Bashkise Tirane. Siç thashe une e kam shlyer kete detyrim...ju lutem me ndihmoni	18.01.2018 Pershendetje Ju bejme me dije se kerkesa juaj per cregjistrim eshte refuzuar, bashkelidhur po ju dergojme vendimin e refuzimit me arsyet perkatese. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

37	17.01.2018	Dear Reader, If I sign the attachment and send my pasport is this form perfectly prepared or are there mistakes? Kind regards,	18.01.2018 Dear Mr. Verhage In response to your e-mail we inform you, that the initial registration and every other registration is performed through an application at any service window of the NBC throughout the territory of the Republic of Albania, independently from the place of exercising the activity, domicile or headquarters of the applicant.	Perfunduar	Nuk ka
38	17.01.2018	Ju lutem kerkoj per statusin e aplikimit per ç'regjistrim te subjektit me Nipt:K91409028S pasi jam likujdatori dhe kam aplikuar me nr. ceshtjeCN-560164-11-17. Faleminderit per mirekuptimin	18.01.2018 Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-560164-11-17 është miratuar dhe subjekti aktualisht figuron me status: Çregjisruar. Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare: www.qkb.gov.al.	Perfunduar	Nuk ka
39	17.01.2018	Pershendetje Subjekti Miranda Nakaj me Nipt K61729504Q, ka kerkuar nga DRT Durres Terheqjen e refuzimit, per Aplikimin e bere per cregjistrim ne QKB CN-540057-04-11	18.01.2018 Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se subjekti me NUIS (NIPT) K61729504Q u çregjistrua. Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

40	17.01.2018	Pershendetje. Bashkengjitur keni nje kerkese per informacion. Iu lutem ktheni pergjigje ne kohen me te shpejte te mundshme.	19.01.2018 Pershendetje, Lidhur me kerkesen e depozituar prane QKB, ju bejme me dije se nga kontrolli ne Regjistrin e Biznesit nuk na rezulton asnje subjekt qe te kete falimentuar ne periudhen e kerkuar. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
41	18.01.2018	Pershendetje Kam ber aplikimin per shitm administratori ka 2 dite dhe akoma nuk ka dal qe eshte miratuar. Mund te me thoni pse nuk ka dal Nipti firmes L12407005L	19.01.2018 Përsëhendetje, Ju bëjmë me dije se, aplikimi i kryer për subjektin me NUIS (NIPT) L12407005L është miratuar. Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
42	18.01.2018	Pershendetje, Ju lutem a mund te me ndihmoni ne lidhje me nje pyetje, Kemi nje rast ku nje person/individ ka dy profesione te ndryshme (pra eshte diplomuar po themi si ekspert kontabel dhe Vleresues pasurish) Ky person do te hape 2 Nipte te ndryshme si Person FIZIK, per dy profesionet e lira respective.	19.01.2018 Pershendetje Ne lidhje me pyetjen tuaj ju bejme me dije se, Personi fizik mund te hapi 2 ose me shume NIPTE te ndryshem prane qendres Kombetare te Biznesit	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

43	18.01.2018	Pershendetje, Kisha nevojë për ndihmën tuaj në lidhje dorezimit të bilancit të vitit 2015 pasi sbej dot veprime. Pasi kam paguar gjoben prej 15 000 lekesh, nuk e disponoj mandat pagesen. A mund ta pranoni bilancin pa mandat pagesen e gjobes pasi nuk dal debitor në sistem??	19.01.2018 Pershendetje Lidhur me pyetjen tuaj ju informojmë se, pa mandatin e pageses ju nuk mund të depozitoni bilancin pranë Qendres Kombetare të Biznesit. Per të bërë të mundur paisjen tuaj me mandate ju mund të terhiqni dublikaten pranë bankes ku pretendoni që keni kryer pagesen. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
44	18.01.2018	Kerkojme një informacion ligjor dhe administrativ në lidhje me procedurat e rregjistrimit në qkr dhe dokumentacionin përkatës të një kompanie me status ligjor , SHOQERI E THJESHTE , pasi kompania ka arritur objektivin e kohezgjatjes dhe ka arritur dhe objektivin e themelimit ka perfunduar kontratën përkatëse.	19.01.2018 Pershendetje, Bashkelidhur po ju dergojme dokumentacionin e kerkuar nga ana juaj. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
45	19.01.2018	Pershendetje! Ju lutem si mund të më thoni kur një emer quhet i ngjashëm me një emer tjetër pasi kam aplikuar tre here dhe pergjigja është: emri është i ngjashëm Ne pritje të suportit tuaj	19.01.2018 Përshëndetje, Nisur nga emaili juaj ju sqarojmë se, lidhur me rregullat për emrat dhe emërtimet tregtare mund t'i referoheni VKM 537, datë “Për rregullat për emrat dhe emërtimet tregtare”, të cilën mund ta gjeni edhe në faqen zyrtare www.qkb.gov.al.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

46	22.01.2018	Pershendetje! Jam e interesuar te di nese nje Ndermarrje Individuale, e regjistruar ne Kosove, mund te hape dege ne Republiken e Shqiperise dhe nese po, cilat jane dokumentat qe duhet te plotesoje?	23.01.2018 Pershendetje, Bashkelidhur po ju dergojme dokumentacionin e kerkuar nga ana juaj. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
47	22.01.2018	Ju lutem Kerkoj te bej nje njoftim per kreditorët dhe debitorët se shoqëria jone është në likuidim e sipër për mbyllje	23.01.2018 Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju informojme si me poshte vijon: Pas miratimit të aplikimit të fazës së parë, likuidatori i shoqërisë harton ftesën e parë drejtuar kreditorëve të shoqërisë, të cilën e sjell për publikim në QKB, pas 30 ditësh nga publikimi i ftesës së parë drejtuar kreditorëve, likuidatori sjell në QKB për publikim ftesën e dytë drejtuar kreditorëve , pas 30 ditësh nga publikimi i ftesës së dytë likuidatori aplikon për cregjistrimin e shoqërisë.	Perfunduar	Nuk ka
48	23.01.2018	Pershendetje! Bashkengjitur dokumentacioni per ankimim.	24.01.2018 Përshëndetje, Nisur nga Ankesa juaj ju sqarojmë se, duhet të riaplikoni për cregjistrim me te njejtin dokumentacion. Më pas QKB do të ndjeke procedurat ligjore lidhur me cregjistrimin tuaj. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
49	23.01.2018	Pershendetje! Kam bere nje aplikim per ekstrakt te thjeshte dhe historik sot por doja qe kte ekstrakt ta merja ne anglisht. A mund te me ndihmoni me kete gje?	24.01.2018 Pershendetje Lidhur me e-mailin tuaj ju bejme me dije se, Qendra Kombetare e Biznesit nuk leshon akte ne gjuhe te huaj, aktet leshohen vetem ne gjuhen amtare.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

50	23.01.2018	Pershendetje Desha te di cfare dokumentash me nevoiten ne QKB nese do bej transferim aktiviteti nga nje kompani ne tjetren?	24.01.2018 Pershendetje Ne lidhje me emailin tuaj, lutemi te na vendosni ne dispozicion informacione me te detajuara ne lidhje me aktivitetin qe ju ushtroni apo formen ligjore te biznesit qe ju deshironi te transferoheni, me qellim informimin tuaj sa me sakte. Faleminderti.	Perfunduar	Nuk ka
51	24.01.2018	Përsëhendetje, Në përgjigje të email-t tuaj ndaj kërkesës tonë për informacion të datës 18/12/2017, kërkojmë një sqarim nga ana juaj për pjesën e tarifës për shërbimet dytësore që ju citoni në email. Ne kemi kërkuar informacion për 140 deputetët e parlamentit shqiptarë nëse janë aksioniere të ndonjë biznesi të regjistruar në QKB, ndaj tarifa që duhet paguar për këtë shërbim është një e vetme apo tarifë për secilin nga 140 emrat.	25.01.2018 Pershendetje Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju bejme me dije se, tarifa qe aplikohet nga Qendra Kombetare e Biznesit eshte nje e vetme, per sherbimin qe ju kerkoni. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
52	25.01.2018	Pershendetje! Me shkresen nr.48 prot, dt.18.01.2018, kemi kerkuar prane QKB venie sekuestro mbi aksionet e subjektit Birra Tirana sh.a me NUIS J61821051F, gjate verifikimeve tona ne ekstraktin historik vume re qe nuk eshte vendosur masa e sekuestros	26.01.2018 Përsëhendetje, Ju bëjmë me dije se, shkresa nr.48 prot, dt.18.01.2018, leshuar nga shoqeria Shoqeria Permbarimore “Studio Pema” sh.p.k, ku eshte urdheruar : Vendosja e mases se sekuestros konservative mbi aksionet e subjektit debitor shoqeria “BIRRA TIRANA” sh.a, pajisur me NUIS (NIPT) – J61821051F është regjistruar dhe publikuar me aplikimin me numër CN-645851-01-18, datë 26.01.2018.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

53	26.01.2018	Pershendetje jam nje subjekt i cregjistruar ne muajin nentor dhe me konfirmoni cregjistrim tim sepse kur shkarkoj ekstraktim me del aktiv nipti im K78618101R	29.01.2018 Pershendetje, Nga verifikimi i kryer ne regjistrin tregtar rezulton se subjekti Shkeqim Lici me NUIS (NIPT) K78618101R, figuron me status i cregjistruar. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
54	29.01.2018	Pershendetje. Bashkengjitur keni nje kerkese per informacion. Ju lutem ktheni pergjigje ne kohen me te shpejte te mundshme	29.01.2018 Pershendetje, Bashkelidhur do te gjeni informacionin e kerkuar. Faleminderit.		
55	29.01.2018	Pershendetje Ju lutem me nevojitet nje informacin nga institucioni juaj lidhur me procedurat dhe dokumentacionin e kerkuar per te bere ndryshimin e aktivitetit tim nga person fizik ne SHPK ,pra subjekt i TVSH-SE	29.01.2018 Përsëhëndetje Në përgjigje të e-mailit tuaj, ju sqarojmë si vijon: Ligji 9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, nuk parashikon kalimin e subjekteve nga person fizik, në person juridik. Mbështetur në nenin 60 të ligjit të sipercituar, Numri unik i identifikimit të subjektit jepet vetëm një herë, në çastin e regjistrimit fillestar dhe është i pandryshueshëm, si dhe nuk u jepet subjekteve të tjera edhe pas çregjistrimit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

56	29.01.2018	Pershendetje Jam i interesuar per hapjen e nje NIPT per fermer ne bujqesi.Ju lutem cfare hapash ndiqen dhe cfare dokumentash duhet te dorezoje per hapjen e tij.	29.01.2018 Pershendetje, Bashkelidhur do te gjeni dokumentacionin e kerkuar nga ana juaj. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
57	29.01.2018	Pershendetje!! Ju lutemi , na konfirmoni statusin e tatimpaguesit Merita Shameti , person fizik me nipt L72330015V , e cila ka bere kerkese per cregjistrim dhe ne sistemin informatik te tatimeve rezulton me status aktiv .	30.01.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju informojme se aplikimi per cregjistrim me date 22.01.2017, i kryer nga subjekti Merita Shameti me NUIS (NIPT) L72330015V, eshte ne statusin cregjistrim ne pritje. Per sa me siper ju bejme me dije se, duhet te prisni afatin 30 ditor, dhe nese nuk keni shlyer detyrimet, ti shlyeni ato ne perputhje me ligjin e sipercituar, me qellim cregjistrimin tuaj nga regjistri tregtar.	Perfunduar	Nuk ka
58	29.01.2018	Sa është numri i <i>call center</i>-ave që operojnë në Tiranë, emri dhe adresa e tyre? Prej sa vitesh operojnë këto <i>call center</i>-a në Tiranë? Kush janë pronarët e këtyre <i>call center</i>-ave?	30.01.2018 Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi. Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipercituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individ/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave. Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

59	30.01.2018	Pershendetje Ju lutem me nevojitet nje informacin nga institucioni juaj lidhur me procedurat dhe dokumentacionin e kerkuar per te bere ndryshimin e aktivitetit tim nga person fizik ne SHPK ,pra subjekt i TVSH-SE	31.01.2018 Pershendetje, Ne lidhje me pyetjen tuaj ju bejme me dije se duhet te paraqiteni prane organeve tatimore me qellim kryerjen e kalimit si subjekt me tvsh.	perfunduar	Nuk ka
60	30.01.2018	Kam aplikuar per hapje nipti me nr ceshtje: CN-639871-01-18 dhe ende nuk ka dale nipti. Ne faqen online nuk ka asnje pergjigje, nderkohe qe kane kaluar disa dite.	01.02.2018 Përsëhëndetje, Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-639871-01-18 është i pezulluar, pasi Statuti mban dy data te ndryshme. (22.01.2018 dhe 26.01.2018). Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
61	01.02.2018	Pershendetje. Nese une hap lokalin me 3 Mars dhe aplikoj per NIPT qe neseser(pasi me nevojitet per dokukenta te tjera leje shfrytezimi etj) kur me hyn ne fuqi detyrimet mua. Ka ndonje mundesi qe detyrimet apo aktivizimi i NIPT te behet nga momenti qe hap lokalin? Faleminderit Arturi.	01.02.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju informojme si me poshte vijon: Mbeshtetur ne nenin 55 te ligjit Nr. 9723/2007, “Per Regjistrimin e Biznesit”, I ndryshuar, QKB-ja , pasi kryen verifikimet perkatese, sipas nenit 54 te ketij ligji dhe veren permbushjen e kushteve per regjistrim, kryen regjistrimin ne regjister dhe leshon certifikaten e regjistrimit brenda nje afati prej nje dite nga data e paraqitjes se aplikimit. Lidhur me pyetjen tuaj ju bejme me dije se qe nga momenti qe hapet numri i Niptit fillojne detyrimet per subjektin. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

62	01.02.2018	Pershendetje Kam aplikuar per hapje nipti me nr ceshtje: CN-639871-01-18 dhe ende nuk ka dale nipti. Ne faqen online nuk ka asnje pergjigje, nderkohe qe kane kaluar disa dite.	01.02.2018 Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-639871-01-18 është i pezulluar, pasi Statuti mban dy data te ndryshme. (22.01.2018 dhe 26.01.2018). Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
63	01.02.2018	Pershendetje. Bashkengjitur keni nje kerkese per informacion. Iu lutem ktheni pergjigje ne kohen me te shpejte te mundshme.	06.02.2018 Pershendetje,Ne pergjigje te kerkeses suaj ju informojme si me poshte: Nr. i bizneseve te çregjistruara ne vitin 2017 eshte 5139 Nr. i bizneseve te çregjistruara ne perjudhen 1 – 11 Janar 2018 eshte 162, Nr. i bizneseve te çregjistruara ne perjudhen 1 – 15 Janar 2018 eshte 247	Perfunduar	Nuk ka
64	06.02.2018	Pershendetje! Me ane te ketij e-maili do t'ju lutesha per nje informacion ne lidhje me statusin e aplikimit per ndryshim likujdatori te subjektit Area Team (Nipt L41609511K) me numer ceshtje CN-624818-01-18.	07.02.2018 Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër CN-624818-01-18 është miratuar. Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

65	06.02.2018	Pershendetje, subjekti Kalivioti shpk eshte aplikuar ne daten 03.08.2017 me nr aplikimi LC 2952 i cili eshte ne satatusin pergatitja e titullit prej me teper se nje muaj. Per sa me siper kerkojme qe subjekti te kaloj ne satatusin aktiv	07.02.2018 Pershendetje, Lidhur me email-in e paraqitur nga ana juaj, ju sqarojmë si më poshte vijon: Qendra Kombëtare e Biznesit me anë të postës elektronike bëri me dije institucionin tjetër vendimmarrës Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për ngarkimin e akt-miratimit të aplikimit dhe perfundimin e procedures per aktivizimin e lejes PN-5971-11-2017 e cila i përket aplikimit me LC-2952-08-2017.	Perfunduar	Nuk ka
66	07.02.2018	Pershendetje, Behet fjale per nje portal sportiv , qe do kete informacione sportive ,, eshte portal jofitimprures,,e kemi regjistruar si Marke tek DPPI - ja por donim te dinim nese eshte e domosdoshme qe te regjistrohet dhe tek QKB-ja????	08.02.2018 Përshëndetje, Në përgjigje të e-mailit tuaj, ju informojmë si vijon: Në mbështetje të nenit 22, të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit” i ndryshuar, subjektet që detyrohen të regjistrohen janë: a) subjektet tregtare; b) shoqëritë e thjeshta, sipas dispozitave të Kodit Civil; c) personat fizikë, sipas kuptimit të Kodit Civil, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, që ushtrojnë veprimtari ekonomike apo një profesion të pavarur; ç) zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare dhe të shoqërive të huaja; d) shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit; dh) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			e) çdo subjekt tjetër, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKR-së. Për sa më sipër, lutemi përcaktoni formën ligjore të veprimtarisë që do ushtroni		
67	08.02.2018	Ne lidhje me aplikimin CN-654989-02-18, bere ne date 02.02.2018, rezulton e pezulluar pa asnje shpjegim dhe shkak ligjor. Bashkelidhur keni vendimin per pezullim ku provohet sa me siper	08.02.2018 Përshëndetje, Në përgjigje të ankesës suaj, ju bëjmë me dije se nga verifikimi në regjistrin tregtar rezulton se, aplikimi me numër çështje CN-654989-02-18, u miratua. Verifikimin mund ta kryeni në faqen zyrtare www.qkb.gov.al. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
68	08.02.2018	Pershendetje , Duke uruar te jeni mire Ju lutem a mund te na informoni se cfare dokumentet duhet te dorezoj per te mirauar zmadhimin e kapitalit te nje shoqerie anonime	09.02.2018 Pershendetje, Bashkelidhur po ju dergojme dokumentacionin e kerkuar. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
69	09.02.2018	Pershendetje Si ka mundesi qe kjo zonje e ka aktivitetin e çregjistruar dhe vazhdon aktivitetin e saj ne Tirane si librari nderkohe eshte shenuar si bar_kafe etj? Kerkoj nje sqarim.Faleminderit	09.02.2018 Në përgjigje të e-mailit tuaj, ju bëjmë me dije se: Kompetencat e Qendrës Kombëtare të Biznesit janë të përcaktuara qartë në ligjin Nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Për sa i përket pretendimeve të përmëndura në e-mailin tuaj, mund t’i drejtoheni organeve kompetente për shqyrtimin e këtyre pretendimeve.	perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

70	11.02.2018	I/E nderuar Kordinator/e Uroj qe emaili im tu gjeje mire. Ju lutem gjeni të bashkangjitur kerkesen time per informacion, e cila eshte e vetësquaruar	12.02.2018 I nderuar Z. Dritan Dema, Në përgjigje të e-mailit tuaj ju informojmë se, kërkesa juaj me lëndë “Kërkim informacioni”, është paraqitur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 12.02.2018. Ju bëjmë me dije se kërkesa juaj do të shqyrtohet sa më shpejt në përputhje me kërkesat e ligjit 119/2014, “Për të Drejten e Informimit”. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
71	12.02.2018	Pershendetje, Kerkoj te me informoni perse nuk ka dale ende certifikata e cregjistrimit per subjektin Thoma Zharkalli me NIPT K92602603T dhe me nr aplikimi CN-618091-01-18.	12.02.2018 Përsëndetje, Ju bëjmë me dije se aplikimi për çregjistrim i kryer për subjektin me NUIS (NIPT) K92602603T është miratuar.	Perfunduar	Nuk ka
72	12.02.2017	Pershendetje. Bashkengjitur keni nje kerkese per informacion. Iu lutem ktheni pergjigje ne kohen me te shpejte te mundshme	17.02.2018 Pershendetje, Bashkelidhur do te gjeni informacionin e kerkuar. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
73	12.02.2018	Pershendetje, jam aplikanti Bashkim Agaj nga Fieri, i cili kam pasur nje aktivitet bar kafe me numer Nipti L62822403T. Duke qene se kam dale ne pension me date 08.01.2018 sipas gjithe rregullave dhe procedurave kam aplikuar er cregjistrimin e aktivitetit i cili nuk me ka ardhur akoma	13.02.2018 Ju bëjmë me dije se aplikimi i kryer për çregjistrimin e subjektit me NUIS (NIPT) L62822403T është refuzuar, bashkelidhur gjeni arsyen e refuzimit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

74	12.02.2018	Pershendetje, Shpresoj te jeni mire. Me duhet te bej nje vendim per subjektin Eldoal shpk ku ortaku per kete shoqeri eshte Feni-Crome Albania shpk. Ne fund te vendimit kush duhet te firmosi Ortaku qe eshte i njejte per te dy shoqerite? Po vendimi meqe eshte i Eldoalit duhet te vulozet nga Eldoali apo nga Feni-Crome Albania?	13.02.2018 Pershendetje, Ne lidhje me pyetjen tuaj ju bejme me dije se, bazuar ne piken 3 te nenit 81 te ligjit 9901/2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar, nese shoqeria zoterohet nga nje ortak, te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortaku I vetem. Per sa me siper vendimi i shoqerise “ELDOAL” duhet te firmoset nga perfaqesuesi i ortakut “Feni-Crome Albania” dhe te vulozet nga shoqeria ”ELDOAL”.	Perfunduar	Nuk ka
75	13.02.2018	Ju konfirmoj se kontrata e shitjes se kuotave me nr. ceshtje CN 640650-01-18 eshte nenshkruar prej meje Fatmir LAÇEJ , noter ne qytetin e Tiranes dhe Zv/president I DHomes Kombetare te Notereve .	14.02.2018 Përsëhëndetje,Ju bëjmë me dije se, aplikimi me numër Cn-640650-01-18 është miratuar. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
76	14.02.2018	Pershendetje, Nuk jam ne dijeni te ketij fakti dhe nga drejtoria tatimore nuk kam mare asnje njoftim per detyrime te papaguara. Kjo gje vertetohet dhe me llogarin e biznesit tim i cili eshte 0 leke detyrime ne tatime.	14.02.2018 Përsëhëndetje, Në vijim të komunikimit, bashkëlidhur po ju dërgojmë shkresën e DRT Fier, lidhur me detyrimet tatimore te subjektit.	Perfunduar	Nuk ka
77	14.02.2018	Miredita, une ETLEVA BUDINI kam bere kerkese per cregjistrim te biznesit tim rregjistruar si person fizik po me kete emer. Kam bere kerkese tek zyrat e QKR Durres qe ne 31/10/2017 dhe biznesi si aktivitet eshte i mbyllur qe ne ate date . Sot vazhdoj te hyj me emrin tim ne QKB dhe me rezulton aktiv	15.02.2018 Përsëhëndetje, Ju bëjmë me dije se subjekti Etleva Budini me NUIS (NIPT) L31623503T është çregjistruar dhe aktualisht subjekti ka statusin: Çregjistruar	perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

170	18.04.2018	Pershendetje, bashkangjitur eshte kerkesa per informim. Pune te mbare	18.04.2018 Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi. Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individ/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave. Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës). Sa më sipër, bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB, tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet pagesa përkatëse.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

171	20.04.2018	Pershendetje kam bere aplikimin CN-743915-04-18, dhe me thote incomplete dhe kur shkarkon dokumentin nuk jep asnje arsye,a mund ta di arsye?	20.04.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju informojme se, duhet te paraqiteni prane sportelit ku keni ber aplikimin per te kryer sakesimin nese ekspertin e doni ne sistem apo per publikim vendimi si dhe te kryeni nenshkrimin e formularit te aplikimit.	Perfunduar	Nuk ka
172	23.04.2018	Pershendetje,ju lutem ne baze te aplikimit te dates 17/04/2018 jemi akoma ne pritje te pergjigjes suaj per themelimin e shoqerise Creating SHPK ne baze te numrit te ceshtjes CN- 744774-04-18	23.04.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju informojme se, pas shqyrtimit aplikimi juaj eshte pezulluar me arsyetimin se: Të saktësohet neni 6 i statutit të shoqërisë, duhet të përmbajë numrin e kuotave.	Perfunduar	Nuk ka
173	25.04.2018	Subjektit me Nipt K81308505B, me forme ligjore "PF", me status Aplikuar per Cregjistrim Me date 29.12.2014 CN-775871-12-14, me seli ne Durres,me shkrese nga DRT Durres nr Prot 840/1 date 30.01.2018 I eshte terhequr refuzimi per cregjistrim. Ju lutem cregjistrojeni pasi nuk ka me detyrime.	25.04.2018 Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se, subjekti me NUIS (NIPT) K81308505B u çregjistrua.	Perfunduar	Nuk ka
174	26.04.2018	Ju lutem me ndihmoni lidhur me procedurat e nevojshme qe duhet te kryejme per te shtuar nje administrator te dyte per nje subjekt.	26.04.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju bejme me dije se per te kryer aplikim per shtim administratori duhet te depozitoni prane sportelve te QKB-se vendimin e asamblese se ortakeve dhe autorizim.	Perfunduar	Nuk ka
175	26.04.2018	Pershendetje, Jam Asistent Lektor prane Universitetit Bujqesor te Tiranes. Ne kuader te nje Projekti qe duam te zhvillojme, do me duhej nje liste e Bletareve te Shqiperise (Emer, Mbiemer, Rrethi, Numer Kontakti). Nuk e di nese keni nje liste te tille dhe nese mund te ma siguroni	30.04.2018 Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi. Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individ/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave. Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës). Sa më sipër, bashkëlidhur, lutemi gjeni shërbimet dytësore, të cilat ofrohen nga QKB, tarifat përkatëse, si dhe faturën e arkëtimit, sipas së cilës mund të kryhet pagesa përkatëse. Në faturën për arkëtim bashkëlidhur lutem të përcaktohet shërbimi dhe shuma për të cilën kryhet pagesa përkatëse.		
176	02.05.2018	Pershendetje, Doja te kisha nje informacion se cfare duhet te bej per te pasqyruar ne ekstraktin e biznesit nje adrese te re te ushtrimit te aktivitetit.	02.05.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju bejme me dije se per te pasqyruar ne ekstraktin e biznesit tuaj nje adrese te re te ushtrimit te aktivitetit ju duhet te kryeni aplikim prane sportelve te QKB-se, duke depozituar dokumentacionin perkates, konkretisht: nese forma ligjore e biznesit tuaj eshte "person fizik" aplikimin e kryen individi ne emrin e se cilit eshte biznesi duke depozituar dokumentin e identifikimit, nderkohe nese forma ligjore e biznesit tuaj eshte "person juridik" ju duhet te depozitoni vendimin e asamblese se ortakeve si dhe autorizim nese aplikimi nuk kryhet nga administratori i shoqerise.	Perfunduar	Nuk ka
177	02.05.2018	Ju lutem me nevojitet nje informacion ne lidhje me shtimin e nje administratori te ri prane nje subjekti. Administratori ekzistues do vijoje te jete administratori por te drejten per te firmosur transfertat bankare do e kete vetem administratori I ri	02.05.2018 Lidhur me kerkesen tuaj ju informojme se, per te kryer aplikim per shtim administratori ju duhet te depozitoni vendimin e asamblese se ortakeve I cili duhet te shprehet per shtimin e adminsitatorit si dhe kompetencat e tij mqs, ju i keni te percaktuara.	Perfunduar	Nuk ka
178	02.05.2018	Dear Sir or Madam, we would like to obtain an extract from trade registry of Albania with an apostille for Russia. Please let me know if we can do it directly through the national business center, your fees for the document apostilled and courier services.	02.05.2018 Dear Madam, We would like to inform you that at the NBC you will be provided with an extract signed and stamped by the NBC employees, regarding the apostil's seal you can get it to the competent authorities in the republic of Albania.	Perfunduar	Nuk ka
179	02.05.2018	Per te hapur nje filjal te nje firme te huaj sllovene ne fushen e hidrosanitareve cfar dokumentash nevoiten Ju faleminderit	02.05.2018 Pershendetje, Bashkelidhur gjeni dokumentacionin e kerkuar. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

180	02.05.2018	Per te hapur nje filjal te nje firme te huaj sllovene ne fushen e hidrosanitareve cfar dokumentash nevoiten Ju faleminderit	02.05.2018 Pershendetje, Bashkelidhur gjeni dokumentacionin e kerkuar. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
181	03.05.2018	Ju lutem me nevojitet nje informacion ne lidhje me statusin e nje aplikimi te kryer dje me date 02/05/2018: CN : 765501-05-18 Subjekti : Premium Media shpk – NIPT L72414030K.	03.05.2018 Pershendetje, Ju bejme me dije se aplikimi juaj u miratua. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
182	04.05.2018	Pershendetje Me date 09.02.2018 kam aplikuar per cregjistrim te biznesit me Nipt L52114556A me nr ceshtje Cn-664642-02-18. Akoma dhe sot nuk kam nje pergjigje . Ju lutem me ndimoni pasi dua te mar vertetim qe nuk kam aktivitet privat por se mar dot pa mare cregjistrimin	04.05.2018 Pershendetje, Ju bejme me dije se aplikimi juaj u miratua. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
183	04.05.2018	Pershendetje, une jam gazetar i "Faktoje" dhe bashkengjitur keni nje kerkese per informacion. Shpresoj ne nje pergjigje sa me te shpejte. Falemnderit	07.05.2018 Pershendetje, Regjistrime te reja per periudhen Janar – Shkurt 2018 jane : 4242 subjekte Kompani me pronesi te huaj 100 % jane : 248 subjekte Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
184	07.08.2018	Ju kontaktojme nga Drejtoria e Informacionit dhe Publikimit prane Agjencise se Prokurimit Publik ne lidhje me problematiken e hasur me llogarine e perdoruesit te operatorit ekonomik me numer NUIS L77715901G i cili ne Sistemin e Prokurimit Elektronik (ketu e ne vijim "SPE") rezulton i bllokuar ne tendera. Te gjitha llogarite e operateve ekonomike bllokohen automatikisht ne SPE ne momentin qe statusi i tyre eshte jo aktiv (pezulluar) dhe ky informacion vjen automatikisht nga te dhenat e sistemit tuaj. Gjithashtu, nga verifikimet e bera ne SPE rezulton se numri i ceshtjes se fundit eshte CN-617449-01-18 i cili nuk eshte i pasqyruar tek ekstrakti historik i ketij subjekti. Sa me siper, ju lutem na konfirmoni statusin e ketij subjekti.	08.05.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju informojme si me poshte vijon: Nga verifikimi I kryer ne regjistrin tregtar rezulton se subjekti "Almir Duka" identifikuar me Nuis L77715901G, rezulton me status aktiv. Subjekti i sipercituar me date 08.01.2018, ka kryer aplikimin me numer ceshtje Cn-617449-01-18, per "cregjistrim biznesi", aplikimi pas shqyrtimit nga nepunesi i autorizuar eshte refuzuar me arsyen se: <i>"QKB nuk mund të çregjistrojë subjektin nëse organi tatimor kompetent ka paraqitur kundërshtime për çregjistrimin e subjektit, në bazë e per zbatim te Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit" dhe Ligjit Nr.9920, datë 14.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 45.Çështja refuzohet, pasi sipas shkresës nr.415, datë 31.01.2018, ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Diber,</i>	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			<i>subjekti ka detyrime të pashlyera/gjoha apo interesa të papaguara me vlerë 2076 leke".</i> Per sa me siper lidhur dhe me pretendimin tuaj se pse aplikimi i fundit i subjektit nuk eshte pasqyruar ne ekstraktin historik te subjektit "Almir Duka" ju bejme me dije se, aplikimi i fundit i kryer nga subjekti eshte refuzuar pas shqyrtimit dhe aplikimet e refuzuara nuk pasqyrohen ne ekstraktin e subjekteve. Faleminderit.		
185	08.05.2018	Pershendetje, Bazuar ne ligjin per te drejten e informimit, bashkangjitur keni nje kerkese per informacion	09.05.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju bejme me dije se: Nga statistikat e gjeneruara , numri i subjekteve te cregjistruara per periudhen e kerkuar prej jush eshte , 24013 subjekte. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
186	09.05.2018	Problematika e Shoqerise Albstar qendron se ne figurojme me dy numer Nipti ne sistemin e QKB prandaj kerkojme nga ana juaj crregjistrimin e ketij nipti NIPT K37209201G nga sistemi	10.05.2018 Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se, subjekti me NUIS (NIPT) K37209201G, u çregjistrua duke depozituar shkreses Nr. 2451/1 Prot., date 04.04.2018 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë.	Perfunduar	Nuk ka
187	15.05.2018	Duke ju uruar pune te mbare, kerkoj nje pergjigje per kerkesen e bashkangjitur me poshte. Ju lutem merreni ne konsiderate. Pune te mbare	15.05.2018 Pershendetje, Bashkelidhur gjeni informacionin e kerkuar. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
188	15.05.2018	Kam aplikuar per shtim te aktiviteteti me nr aplikimi CN-776984-05-14 A mund te marr informacion mbi ecurine e aplikimit	15.05.2018 Pershendetje, Ju bejme me dije se aplikimi juaj eshte miratuar. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

189	16.05.2018	Pershendetje, Kerkoj, ndryshimin e kohezgjatjes se licenses se LFS ALB te rivonuar nga 1 vite ne 3 vite.	16.05.2018 Në përgjigje të email-it tuaj, ju informojmë se u bë ndryshimi i afatit të vlefshmërisë së licencës LN-5038-05-2018. Ju mund të paqraqiteni pranë sporteleve të shërbimit për të tërhequr titullin e licenses. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
190	16.05.2018	Pershendetje, kam kerkuar cregjistrim nipti dhe detyrimet ne drejtorine tatimore jane kryer. Bashkengjitur keni dhe deklarimin qe keto detyrime ne kohe reale per 2018, 03, 13 jane ne 0. Ju lutem beni nje verifikim qe ti kaloje qkb dhe te behet cregjistrimi. Faleminderit.	16.05.2018 Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju informojme se aplikimi qe ju keni kryer per cregjistrim biznesi eshte refuzuar per shkak te detyrimeve qe keni ndaj organeve tatimore. Lidhur me pretendimin tuaj se i keni shlyer detyrimet prane organeve tatimore, lutemi te riaplikoni edhe njehere per cregjistrim, me qellim cregjistrimin e biznesit tuaj nga regjistri tregtar, nese ju nuk figuroni debitore prane organeve tatimore. Faleminderit.	perfunduar	Nuk ka
191	16.05.2018	Pershendetje Ne cfare date mund te dorezohet bilanci vjetor i 2017.	16.05.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju bejme me dije se afati I fundit per depozitimn e pasqyrave financiare eshte data 31 korrik. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
192	18.05.2018	Pershendetje, Ne kuader te Ligjit per te Drejten e Informimit, po i dergoj nje kerkese per informacion te cilen e gjeni bashkelidhur ne kete email. Faleminderit,	18.05.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te kerkeses tuaj ju informojme si me poshte vijon: Mbeshtetur ne nenin 44 te ligjit Nr.9920, "Per procedurat taimore," I ndryshuar, administrata tatimore transferon regjistrimin e tatimpaguesit nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv, që mbahet nga administrata tatimore, në rast se përmbushet, të paktën, një nga kushtet e mëposhtme: a) nuk ushtron më veprimtari tregtare për një periudhë tatimore prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm; b) nuk dorëzon deklaratën tatimore për një periudhë tatimore prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm; c) deklaron në QKR pezullim veprimtarie tregtare. Per sa me siper, sqarojme se subjektet kalojne ne status pasiv prane organeve tatimore, nderkohe qe ligji nr.9723/2007, "per regjistrimin e biznesit", I ndryshuar, nuk parashikon status pasiv per subjektet qe kryejne regjistrime prane regjistrit tregtar.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			Referuar nenit 44, të ligjit të sipercituar subjektet mund të pezullojnë aktivitetin e tyre duke depozituar dokumentacionin perkates. Ne perfundim lutemi të saktësoni kerkesen tuaj, me qellim informimin tuaj sa me sakte. Faleminderit.		
193	18.05.2018	Pershendetje, Per te hapur nje nipt te ri sekondar ne nje venddodhje qe eshte mare me qera. Dokumentat qe duhet te paraqesim pervec vendimit te asamblese se ortakeve, kontrata e qeraseshte eshte e nevojshme?	21.05.2018 Pershendetje, Lidhur me pyetjen tuaj , ju bejme me dije se, per te kryer aplikim prane sporteleve te QKB-se, per ndryshim adrese dytesore, ju duhet te depozitoni vendimine e asamblese se ortakeve, ose kerkese nga administratori i shoqerise, si dhe autorizim nese aplikimi nuk kryhet nga administratori.	Perfunduar	Nuk ka
194	21.05.2018	Pershendetje. Jam nje nxenes maturant i shkolles se mesme Koplik dhe kam nevojte per disa informacione nga ju pasi me nevojiten per nje projekt ne ekonomi. Ne qofte se keni mundesi te me jepni disa informacione ne lidhje me numrin e bizneseve te vogla te regjistruara ne te gjitha Shqiperine dhe vecanerisht ne Malesine e Madhe	23.05.2018 Pershendetje, Lidhur me kerkesen tuaj, ju bej me dije se jane 205061 subjekte aktive te regjistruar ne Regjistrin Tregtar prej se cilave jane 1405 subjekte aktualisht aktive ne Malesine e Madhe. Ndersa ne lidhje me llojin e biznesit (i vogel, i mesem, i madh) lutem kerkesen ta drejtoni prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve (www.tatime.gov.al). Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
195	23.05.2018	Pershendetje me falni per shqetesimin ju lutem mund te me thoni se cilat jane kriteret per krijimin e nje shoqerie komandite? Faleminderit!	24.05.2018 Pershendetje, Mbeshtetur ne nenin 28 te ligjit 9723/2007, "Per regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, Shoqëritë tregtare regjistrohen në regjistrin tregtar, duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, statutin dhe aktin e themelimit, në rast se janë hartuar si dy dokumente të veçanta, aktet e emërimit të organeve të shoqërisë, nëse nuk përfshihen në aktet e mësipërme, si dhe aktet e tjera të nevojshme për themelimin, sipas legjislacionit në fuqi, shoqëritë kolektive, komandite dhe ato me përgjegjësi të kufizuar mund të regjistrohen, gjithashtu, duke depozituar vetëm aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, dokumentet e identifikimit të anëtarëve apo ortakëve dhe duke nënshkruar deklaratën e posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, për organizimin dhe funksionimin e llojit të	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			shoqërisë që regjistrohet. Në këtë rast, aplikimi për regjistrim fillestar dhe deklarata e mësipërme, e nënshkruar sipas rastit nga ortakët, anëtarët ose nga personat e autorizuar të veprojnë në emër e për llogari të tyre, zëvendëson aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë. Faleminderit,		
196	24.05.2018	Kaq te pambrojtura i kam te dhenat qe sapo kam hap firmen po bombardohem me telefonata per ofrim sherbimesh?	24.05.2018 Përshëndetje,Mbështetur në piken 1 të nenit 61 të ligjit Nr. 9723/2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, çdo e dhënë e regjistruar në regjistrin nga QKB-ja publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit, që mbahet nga QKB-ja në format elektronik dhe botohet në faqen e saj zyrtare të internetit. QKB-ja kryen publikimin në buletin brenda një dite nga data e kryerjes së regjistrimit. Për çdo publikim përcaktohet qartë data, në të cilën është regjistruar e dhëna e publikuar. Gjithashtu neni 66 i ligjit të sipërcituar përcakton se, çdo person i interesuar mund të kryej, sipas këtij ligji , pa pagesë pranë çdo sporteli shërbimi, kërtime mbi bazën e të dhënave elektronike për çdo të dhënë të regjistruar, me përjashtim të adresës së banimit të individit. Ndërkohë bazuar në pikën c të nenit 44 të ligjit Nr. 9723/2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, subjektet mund të regjistrojnë çdo të dhënë tjetër, të ndryshme nga të dhënat e përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji, të cilat kanë lidhje me veprimtarinë e tyre. Këto të dhëna përfshijnë por pa u kufizuar në to: c) Web-site, e-mail, telefon, faks. Për sa më sipër referuar dispozitës së sipërcituar ju bëjmë me dije se, website, email, telefon, faks përbejnë të dhëna vullnetare, të cilat subjekti i deklaron me vullnetin e tij të plotë.	Pershendetje	Nuk ka
197	24.05.2018	Kompania jone eshte shpallur fituese per nje leje minerare.Ju lutem mund te me beni nje liste te detajuar mbi dokumentacionin e nevojshem qe dueht te paraqesim ne QkB	24.05.2018 Pershendetje, Bashkelidhur po ju dergojme dokumentacionin qe duhet te plotesoni per tu pajisur me leje shfrytezimi. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
198	24.05.2018	Ju lutemi na tregoni se çfare dokumentesh na nevojiten per tu pajisur me leje mjedisore per Spitalin.	24.05.2018 Pershendetje, Aktiviteti juaj , ka nevojë për : Leje mjedore te tipit B. Bashkelidhur po ju dergojme dokumentacioni qe duhet plotesuar per tu pajisur me kete leje. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

199	24.05.2018	Pershendetje kam aplikuar dje per nje licens sekondare Me nipt k74219408h doja te dija a eshte miratuar	24.05.2018 Pershendetje, Ju bejme me dije se aplikimi juaj eshte miratuar. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
200	24.05.2018	Ju lutem me verifikoni pak subjektin me Nuis:L61621052A me emertimin IL-AD Company? Pasi sistemi nuk po ma nxjerr . flm	25.05.2018 Pershendetje, Nga verifikimi I kryer ne regjistrin tregtar, rezulton se subjekti "IL-Ad" me NUIS L61621052A, nuk figuron I regjistruar prane regjistrit tregtar. Nderkohe nga verifikimi rezulton se eshte I regjistruar subjekti "ILAD" identifikuar me NUIS J81822501H Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
201	28.05.2018	Kerkojme nje shpallje prane QKR per subjektin "Kcira" shpk, derguar nga gjykata Administrative e shkalles se pare Shkoder rreth date 10-17 Janar 2018.	28.05.2018 Pershendetje, Bashkelidhur, gjeni shpalljen nga Gjykata Administrative e Shkalles se pare Shkoder, per subjektin "Kcira" shpk. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
202	28.05.2018	Pershendetje, Duke qene se nuk po na hapet faqa e QKB-se donim te verifikonim nese subjekti EXTRACLEAN - 18 me NIPT L86407209b ka si objekt veprimtarie ndertime, mirembajtje dhe rikostruksion objektesh civile. Faleminderit	28.05.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj, ju informojme se nga verifikimi I kryer ne regjistrin tregtar rezulton se subjekti "EXTRACLEAN - 18" me NIPT L86407209b, ka objekt te veprimtarise se tij: Sherbime pastrimi dhe mirembajtjeje te ambienteve te brendshme dhe te jashtme, industriale dhe civile, publike dhe private, reklamave e totemeve te ambienteve spitalore, qendrave shendetsore, qendrave tregtare, hoteleve, zyrave, universiteteve, marketeve, bankave, bar-restoranteve, porteve, aeroporteteve, terminaleve etj me punonjesit tane.Pastrime te perdritshme, pastrime speciale, pastrime pas rikonstrusioneve, lysterjeve etj. Larje, pastrim trajtim dhe lugidim te dysHEMEVE te te gjitha llojeve, pastrim te fasadave te te gjitha llojeve ne cdo lloj lartesisie. Pastrime dhe trajtime te veprave te artit. Pastrim dhe larje te kolltuqeve, divaneve, karrikeve, te cdo lloj tavani, tapeteve, moketeve, perdeve te holla e te trasha, grilave etj. Sherbime lysterje,	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			patinime, suvatime ne cdo lloj lartesis. pastrim te sistemeve te aspirim-kondicionimit(HVAC-Heating, Ventilation and Hair Conditioning), aspiratoreve te kuzhinave, pajisjeve te sistemeve industriale dhe te restoranteve, hoteleve, lavanderive (dry-cleaning), qendrave tregtare, spitaleve, apartamenteve dhe banesave private etj. Sherbime elektrike dhe tregtim te materialeve elektrike.Sherbime hidraulike dhe tregtim te materialeve hidraulike.Administrim i bashkepronesise ne ndertesa. Faleminderit,		
203	29.05.2018	pershendetje , Ju lutem dua te informohem per gjendjen e aplikimit me CN-764087-04-18 per cregjistrim biznesi Person Fizik L52101541C u informova tek tatim taksa Durres dhe personi pergjegjes me informoj se nuk i ka ardhur shkrese nga QKB . Ju lutem me info Faleminderit	29.05.2018 Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se, aplikimi për çregjistrim me numër CN-764087-04-18 është miratuar. Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
204	29.05.2018	A ka ndonje menyre per te denoncuar nje biznes qe vepron ne menyre te paligjshme ne menyre anonime	29.05.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju bejme me dije se, mbështetur në nenin 4 të ligjit 9723/2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, QKB-ja ka këto funksione: 1. Mban regjistrin tregtar; 2. Kryen regjistrimet në regjistrin tregtar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji; 3. Kryen regjistrimin e subjekteve, të përcaktuara në këtë ligj, për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe inspektimit të mardhënies së punës; 4. Lëshon çertifikata, ekstrakte të regjistrimeve dhe kopje të vërtetuara të akteve, të depozituara sipas përcaktimit të këtij ligji; 5. Publikon të dhënat e regjistrit të mbajtur, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to; 6. Informon dhe këshillon për procedurat e regjistrimit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			Lidhur me kerkesen tuaj, ju orientojme tui drejtoheni organeve kompetente perkatese. Faleminderit.		
205	29.05.2018	Jam e interesuar per te bere nje aplikim per leje mjedisi tipit C. Kerkova ne adresen tuaj dhe nuk po e gjej formularin informuse. Ju lutem mund te me thoni se ku mund ta gjej kete formular.	29.05.2018 Pershendetje, Bashkelidhur, gjeni kriteret e licencimit per te kryer aplikim per leje mjedisi tipi C. Nderkohe persa I perket formularit informues, lutemi te paraqiteni prane Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit dhe institucioneve te variesise, AKM, ARM.	Perfunduar	Nuk ka
206	29.05.2018	Pershendetje! Kam bere aplikim me Nr. CN-784061-05-18. Nga kontrollet ne sistemin tuaj per statusin e ketij aplikimi marr pergjigje "Nuk u gjet asnjë rezultat me këtë kërkim". Ju lutem me sygjeroni si te veproji pasi nuk kam mundesi fizike edhe per pak kohe te shkoj ne ndonje sportel. Faleminderit dhe gjithë te mirat	29.05.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju informojme si me poshte vijon: Nga verifikimi I kryer rezulton se aplikimi me nr. CN-784061-05-18, pas shqyrtimit nga nepunesi I autorizuar eshte pezulluar me arsyen se: Në zbatim te nenit 15, te ligjit 129/2014 “ Për disa shtesa në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Administratori, që jep dorëheqjen, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblesë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi. Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Biznesit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

207	29.05.2018	Pershendetje Ju lutem a mund ta pezulloj une licencen per agjenci udhetimi ne menyre qe ta rihap kur te dua te ushtroj aktivitet	30.05.2018 Pershendetje, Referuar nenit 44 te ligjit 9723/2007, pezullimi eshte nje e dhene vullnetare, I cili kryhet me kerkesen e subjektit. Per sa me siper ju mund te kryeni pezullim aktiviteti, duke depozituar prane QKB-se dokumentacionin perkates, konkretisht: a) Kerkese nga administrator me nenshkriumin e tij dhe vulen e shoqerise; b) Vendimin e asamblese se ortakeve, si dhe autorizim nese aplikimi nuk kryhet nga administrator I shoqerise. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
208	30.05.2018	Pershendetje, isha i interesuar te dija nqs mund te rezervoja emrin e nje subjekti(biznesi). A eshte ky nje sherbim i ofruar nga ju, nese po per sa kohe zgjate ky rezervim, cila eshte kostoja e tij dhe ku duhet te paraqitem per te ber nje rezervim te tille?	31.05.2018 Pershendetje, Bazuar ne nenin 24 te ligjit 9723/2007, "Per regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, cdo individ, duke paguar tarifen perkatese, ka te drejte te rezervoje prane regjistrat tregtar, per llogari te tij apo te te treteve, nje apo me shume emra te caktuar per regjistrim. QKB-ja leshon nje certificate per rezervimin e emrit brenda nje dite nga dorezimi i aplikimit. Rezervimi I emrit eshte I vlefshem per nje afat prej 30 ditesh, duke nisur nga data e rezervimit. Tarifa per kryerjen e aplikimit per rezervim emir, eshte 100 leke. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
209	31.05.2018	Pershendetje, Me duhet nje specifikim i ligjit per regjistrimin e nje bizesi, nqs ka ndonje percaktim te detajuar mbi Objektin e aktivitetit, nese mund te jene ose jo dy specifikime te ndryshme brenda nje Nipti. Ju lutem nje baze ligjore nqs lejohet ose jo	01.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju informojme si me poshte vijon: Bazuar ne nenin 30 dhe 32 te ligjit 9723/2007, "Per regjistrimin e biznesit", I ndryshuar, per regjistrimin fillestar te personave fizik dhe te shoqerive tregtare jane te detyrueshme keto te dhena: a) objekti nese eshte I percaktuar, c) fusha e veprimtarise nese eshte e percaktuar Per sa me siper ju bejme me dije se, percaktimi i objekti eshte nje e dhene e detyrueshme, dhe ligji nuk parashikon kufizime ne lidhje me fushat e veprimtarise qe do te zgjedhi subjekti te ushtroje. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

210	01.06.2018	Pasqyrat financiare te vitit 2017 jane depozituar me CN-780519-05-18 date 15.05.2018. Kerkojme nga ana juaj qe pasqyrat financiare te vitit 2017 te depozitohenme numer ceshtje CN-792957-05-18, me date 23.05.2018.	04.06.2018 Pershendetje, Ne vijim te komunikimit ju bejme me dije se, mbeshitetur ne piken 2 te nenit 65 te ligjit 9723/2007, "Per regjistrimin e biznesit", I ndryshuar, Ndryshimi i te dhenave te pasakta, te ndryshme nga ato te parashikuara ne piken 1 te ketij neni,kryhet nepermjet nje aplikimi te ri, apo ne baze te nje vendimi gjyqesor. Per sa me siper ju informojme se, ju mund te kryeni aplikim te ri per depozitim e pasqyrave financiare te ndryshuara, duke depozituar edhe aktet qe specifikojne dhe miratojne ndryshimin e pasqyrave financiare. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
211	04.06.2018	Pershendetje, Ju lutem gjeni bashkelidhur shkresen e Komisionerit per te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e te Dhenave Personale. Kjo shkrese eshte nisur edhe ne rruge zyrtare. Ju lutem konfirmoni pjesemarrjen ne adresen info@idp.al brenda dates 3 Qershor 2018.	04.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te e-mailit tuaj, ju bejme me dije se, konfirmojme pjesemarrjen e perfaqesueseve nga Qendra Kombetare e Biznesit. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
212	04.06.2018	Pershendetje ! Jam administratore e shoqates ITALIANEVE NE SHQIPERI (SHKODER)TRIAL ME NIPT L76926131D. Jam ne dijeni gojarisht qe aplikimi imnr LC-8658-05-2018 data 07/05/2018 (qe per mua eshte aplikim I dyte) me eshte refuzuar nga ministria perkatese. Besoj qe e ka kaluar afatin ligjor qe refuzimi te transmetohet ne qendren tuaj ne menyre qe une te mund te bej riaplikim ,pra aplikim te ri . Ju lutem me ndihmoni te kryej normalisht procedurat e reja! Faleminderit	04.06.2018 Pershendetje , Referuar e-mailit tuaj, nga kerkimi ne regjistrin e leje /licencave rezulton se: Per aplikimin me numer LC-8658-05-2018, date 07/05/2018, nga ana e institucionit tjetër , ne daten 21.05.2018 eshte kerkuar shtyrje afati per vendimarrjen. Afati i fundit per vendimarrje eshte data 06.06.2018. Statusi i aplikimi eshte”Institucioni tjetër ne proces”. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

213	04.06.2018	Pershendetje jam nje subjekt nga durresi me NIPT L22111501V dhe kerkoj te cregjistrohem i kam bere te gjitha pagesat ndaj instiucioneve perkatsë por kur bej aplikim per cregjistrim me kerkojne vertetimin nga gjykata administrative qe nuk kam detyrime ,e kam marre vertetimin qe nuk kam detyrime e kam skanuar ke QKB e durresit disa here dhe kthehet mbrspsht ,i kam cuar dhe vertetimin nga tatimet qe nuk kam detyrime dhe e kane skanuar,ju lutem pres pergjigje se si duhet te procedoj,ju faleminderit.	04.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju informojme si me poshte vijon Nga verifikimi I kryer ne regjistrin tregtar rezulton se aplikimi juaj eshte pezulluar me arsyen se: <i>Te depozitohet urdheri Zyres Permbarimore Durres qe ben zhblokimin e licences te vendosur me Urdherin Nr. 05/29 date 06.01.2014.</i> Per sa me siper me qellim miratimin e aplikimit tuaj, lutemi te depozitoni urdherin e zyres permbarimore Durres qe miraton zhblokimin e urdherit Nr. 05/29 date 06.01.2014. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
214	04.06.2018	A mund te rregjistrohet nje shtetas i huaj (Italian) si PERSON FIZIK? Faleminderit	04.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj, ju bejme me dije se shtetasit e huaj mund te regjistrohen prane QKb-se duke paraqitur te njejtat akte si shtetasit shqiprat, konkretisht personat fizik depozitojne dokumentin e identifikimit. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
215	04.06.2018	pershendetje! doja te beja aktivizimin e niptit,duhet te paraqitem tek dega e QKB ne rrethin ku e kam adresen apo mund ta bej ne cdo dege QKB te nje rrethi tjeter? Faleminderit	05.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju informojme se, mbeshtetur ne nenin 20 te ligjit 9723/2007, "Per regjistrimin e Biznesit", I ndryshuar, regjistrimi fillestar si dhe cdo regjistrim tjeter behet me aplikim prane cdo sporteli sherbimi te QKB-se ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së aplikantit. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
216	05.06.2018	Pershendetje. jam Ekspert mjedisi. Dy dite me pare ju kemi cuar nje email per proceduren e Revokimit te nje leje mjedisore te vjeter per shkak se kemi aplikuar per nje leje te re mjedisi tipi C. Ne mungese te nja sqarimi te detajuar po ju percjellim kerkesen zyrtare per revokimin e kesaj leje bashkangjitur kopjen e lejes. Ju faleminderit	05.06.2018 Pershendetje, Përsa i përket kërkesës tuaj për revokimin e lejes mjedisore, lutemi të dorëzoni kërkesën pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të vijuar me tej me procedurat e revokimit. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

217	05.06.2018	Ju lutem ma shikoni pak CN-808703-06-18 behet fjale per NIPT sekondar, kane kaluar 24 ore dhe neses kemi hapjen e aktivitetit keshtu qe na duhet sa me shpejt.	06.06.2018 Pershendetje, Nga verifikimi i kryer ne regjistrin tregtar rezulton se aplikimi me nr. CN-808703-06-18 , eshte miratuar. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
218	06.06.2018	Pershendetje, Ju shkruajme nga AUTO JAPAN sh.p.k me aktivitet servis dhe shitje pjese kembimi. Nga ana Juaj dhe Ministrise perkatese na eshte kerkuar te hapin licence per aktivitetet tona dhe ne jemi te gatshem te veprojme sipas ligjit, por ne proces e siper te pergatitjes se dokumentave kemi hasur veshtiresis tek dokumenti qe verteton ngurtesimin e vleres se garancise financiare prej 100.000 (njeqind mije) leke, sepse bankat e kane te paqarte si do funksionoj ky ngurtesim...objekti , qellimi dhe menyra se si do te zhbllokohet fondi ne menyre qe banka te jape garanci.	07.06.2018 Pershendetje, Lidhur me kërkesën e paraqitur me anë të postës elektronike, ju sqarojmë si më poshtë vijon: Në VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, citohet se “ <i>Kur sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, njëra nga kriteret e posaçme është edhe një garanci e caktuar financiare, subjekti dorëzon së bashku me kërkesën edhe një akt që vërteton se shuma e caktuar financiare është ngrirë dhe/ose garantohet nga një institucion financiar i licencuar sipas legjislacionit në fuqi. Garancia duhet të jetë e vlefshme për të gjithë afatin e vlefshmërisë së licencës</i> ”. Për çdo informacion të mëtejshëm mund të paraqiteni pranë sporteleve të shërbimit të QKB-së. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
219	07.06.2018	Pershendetje, jam nje bashkepunetore e Studios Ligjore Durazzo e Pellizzaro qe ka seli ne Torino (Itali) dhe shkruaj ne emer te avv. Nicola Durazzo per te kerkuar nje informacion mbi regjistrimin e Joint Venture dhe ligjin qe i rregullon ato ne Shqiperi	07.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju informojme si me poshte vijon: Shoqerite Joint Venture regjistrohen prane QKB si shoqeri me forme ligjore "shoqeri e thjeshte", konkretisht: Ne mbeshetjetje te nenit 28 te ligjit 9723/2007, "Per regjistrimin e biznesit", I ndryshuar, shoqerite e thjeshta regjistrohen duke depozituar aplikimin per regjistrim fillestar, te plotesuar me te gjitha te dhenat e detyrueshme, sipas ketij ligji, kontraten perkatese sipas parashikimeve te Kodit Civil dhe kopje te dokumenteve te identifikimit te antareve. Ne rast se palet nuk kane lidhur kontrate me shkrim, regjistrimi i shoqerise se thjeshte mund te kryhet duke depozituar vetem aplikimin, te plotesuar me te dhenat e detyrueshme, kopje te dokumenteve te identifikimit dhe duke nenshkruar deklaraten e posacme per njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore ne fuqi, per organizimin dhe funksionimin e shoqerise se thjeshte.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			Nderkohe ne nenin 31 te ligjit te sipercituar percaktohen te dhenat e detyrueshme per krijimin e nje shoqerie te thjesht. Faleminderit.		
220	07.06.2018	Pershendetje, Jam I interesuar te di nese ka Ligj, V.K.M. ose Udhezim i Ministrise se Financave qe detyron Personat fizike, te cilet pagen, te punesuarit, qofte edhe pagat e tyre, t'i marrin nepermjet nje banke te nivelit te dyte. Faleminderit, ne pritje te nje pergjigje nga ana juaj, Veledin Iliazi	08.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju informojme si me poshte vijon: Ne lidhje me kerkesen tuaj ju informojme se bazuar ne nenin 4 te ligjit 9723/2007, “Per Regjistrimin e Biznesit”, I ndryshuar, QKB_ja ka keto funksione: 1. Mban regjistrin tregtar; 2. Kryen regjistrimin e subjekteve te percaktuara ne kete ligj, per qellim te regjistrimit fiskal, te sigurimeve shoqerore e shendetesore, si dhe inspektimit te mardhenieve te punes ; 3. Leshon certifikata, ekstrakte te regjistrimeve dhe kopje te vertetuara te akteve, te depozituara sipas percaktimit te ketij ligji; 4. Publikon te dhenat e regjistrimit te mbajtur, si dhe siguron aksesin e lire te publikut ne to; 5. Informon dhe keshillon per procedurat e regjistrimit Per sa me siper ju bejme me dije se ne lidhje me kerkesen tuaj duhet te drejtoheni prane organeve kompetente perkatese me qellim informimin tuaj sa me sakte. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
221	08.06.2018	A mund te me thoni cfare dokumentesh duhet te paraqiten tek ju per te marre nje licence per kryerjen e sherbimit te perkthimit	12.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju bejme me dije se prane QKB-se nuk licensohen perkthyesit, lutemi te drejtoheni prane organeve kompetente perkatese, konkretisht Ministrise se Drejtesise.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

222	12.06.2018	Jam administratori i shoqërisë redian shpk perpara disa ditesh kam bere nje kerkese qkb per te hequr nje nipt qe e kam ne elbasan kur kam punuar atje mirpo financeri me ka hequr gabimisht nip-tin ne Durres,me qe eshte po i njejti .Erdha pyeta tek Ju me thane qe do te kthejme pergjigje,por deri me sot nuk me kane kthyer pergjigje.	12.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju bejme me dije se: Qkb I eshte drejtuar me shkresen me nr. 4757/1 date 15.05.2018, Drejtorise se pergjithshme te tatimeve, Drejtorise rajonale Durres dhe ELbasan, me ane te se ciles kerkojme: Nëse këto dy NUIS (NIPT-e) i përkasin të njëjtit subjekt (njëri është kryesor dhe tjetri dytësor), apo bëhet fjalë për dy subjekte të ndryshme? Nëse po, cili është NUIS (NIPT-i) kryesor dhe cili është dytësor? Ky informacion kërkohet, pasi subjekti ka paraqitur shkresë në QKB me anë të së cilës kërkohet anulimi i likuidimit të shoqërisë “Redian” sh.p.k, me NUIS(NIPT) K32306502K, me pretendimin se ka ndodhur një ngatërresë, pasi në fakt duhet të bëhej likuidimi i shoqërisë “Redian” shpk, me NUIS(NIPT) K12531205H dhe me adresë në Elbasan. Per sa me siper jemi ne pritje te pergjigjes nga organet tatimore perkates. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
-----	------------	---	---	------------	--------

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

223	12.06.2018	Ne perputhje me ligjin 119/2014 “Per te drejten e Informimit”, ju lutem gjeni bashkengjitur ketij emaili Kerkesen per Informacion se bashku me Dokumentin e Identifikimit te Skanuar. Duke iu falenderuar per vemendjen, mbetem ne pritje te nje pergjigjeje.	13.06.2018 Ne pergjigje te kerkeses tuaj per informacion ju bejme me dije se: Lidhur me piken e pare te kerkeses tuaj mbi numrin e organizatave jo fitimprurese qe jane licencuar prane QKB-se ju informojme se, informacioni qe ju kerkoni eshte marre ne shqyrtim nga sektori perkates dhe eshte ne fazen e procesimit. Lidhur me piken 2 te kerkeses tuaj, nepermjet se ciles kerkoni listen emerore te ketyre subjekteve si dhe licencat perkatese per vitet 2016, 2017, 2018 sqarojme se: Neni 11, i Ligjit Nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” përcakton se, <i>"QKB-ja realizon të ardhura nga kryerja e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj dhe nga ofrimi i shërbimeve të tjera shtesë, në mbështetje të këtyre funksioneve"</i>. Gjithashtu, pika 2, neni 13, i Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar, citon se, <i>"Ministri përcakton shërbimet e tjera, që ofrohen nga QKB-ja, tarifat e të cilave miratohen me propozimin e tij nga Ministri i Financave"</i>. Bazuar në përcaktimin ligjor të sipërcituar, dëshirojmë t’ju informojmë se pika 2 e kerkeses tuaj lidhur me listen emerore te Organizatave Jo fitimprurese te regjistruara prane QKB, përbën një shërbim dytësor që ofrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit kundrejt një pagese të caktuar. Bashkelidhur do te gjeni listen e shërbimeve dytesore te ofruara nga Qendra Kombetare e Biznesit, si dhe faturen per arketim.	Perfunduar	Nuk ka
224	13.06.2018	Investitorja znj. Yadira Maria Vasquez Batista ka aplikuar per regjistrim me date 11.06.2018 Me CN-815466-06-18	14.06.2018 Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se aplikimi me numër CN-815466-06-18. Është miratuar. Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

225	13.06.2018	Pershendetje, Ju lutem mund te me thoni nese eshte e mundur qe te hapen dy nr nipti te ndryshem brenda nje biznesi? faleminderit	14.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju informojme si me poshte vijon; Mbeshtetur ne nenin 43, te ligjit 9723, date 03.05.2007, “Per Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, Cdo subjekt qe kryen regjistrimin fillestar, mbart edhe detyrimin te regjistroje cdo ndryshim ne te dhenat e njoftuara dhe ne dokumentet shoqeruese, subjekti duhet te regjistroje vendet e tjera te ushtrimit te veprimtarise, te ndryshme nga selia. Per sa me siper ju bejme me dije se subjekti mund te hapi Nipt sekondar (adrese dytesore). Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
226	14.06.2018	Jam e interesuar per regjistrimin e licences se ndermjetesimit dhe licences se avokatise (hapje nipti) dokumentacioni qe m3 nevojitet	18.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te e-mailit tuaj ju informojme se, neni 28 i ligjit nr.9723/2007, "Per regjistrimin e biznesit", I ndryshuar, parashikon se personat fizik regjistrohen prane sporteleve te QKB-se duke depozituar aplikimin fillestar per regjistrim dhe dokumentin e identifikimit. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
227	18.06.2018	Pershendetje.Po ju shkruajme nga Ujesjelles Malesi e Madhe. Kemi nevojte te bejme nje ndryshim ne Ekstraktin (emertimin) nga Ujesjelles Malesi e Madhe ne Ujesjelles Kanalizime Malesi e Madhe. Donim te dinim ekzaktesisht cilat jane dokumentat qe duhet te paraqesim prane Qendres Kombetare te Biznesit ne menyre qe te behet ky ndryshim?	19.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju informojme se per te kryer aplikimin per ndryshimin e emertimit tregtar, duhet te paraqitni per depozitim prane sporteleve te QKB-se vendimin e asamblese se ortakeve si dhe autorizim ne rast se aplikimi nuk kryhet nga administratori I shoqerise. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
228	19.06.2018	Pershendetje. Jam i interesuar per te hapur nje biznes veror. (sezonal) Ca duhet te bej? Faleminderit	20.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju bejme me dije se, nese biznesi qe ju do te ushtroni do te jete i formes ligjore "person fizik" ju duhet te paraqiteni prane sporteleve te QKb per te kryer aplikim, per regjistrim biznesi duke depozituar dokumentacionin perkates, konkretisht dokumentin e identifikimit. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

229	20.06.2018	Kam kryer nje aplikim per license qe me dt. 31.05.2018 dhe akoma nuk kam marre nje pergjigje. Ligji e ka qe koha eshte max 15 dite. A mund te me informoni pse kjo vones kaq e madhe? Nipti: L81721502J	20.06.2018 Pershendetje, Nga verifikimi ne regjistrin kombetar te leje/ licencave, aplikimi juaj me numer LC-9324-05-2018, eshte duke u shqyrtuar ne Institucionin pergjegjes per vendimarrjen.Ky afat perfundon ne daten 27.06.2018. Afati i shqyrtimit per aplikimin tuaj eshte 15 dite pune -jo kalendarike. Nese institucioni tjeter nuk jep vendim miratimi, aplikimi miratohet me “Miratim ne Heshnje”. Bashkelidhur statusi i aplikimit tuaj. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
230	20.06.2018	Kemi aplikuar me dt 13.06.2018 . Depozitimin e Pasqyrave Financiare viti 2017 dhe vendimin e Asamblese se Ortakut per caktimin e fitimit sipas bilancit. Nuk kemi mare konfirmim nga ju nese eshte pranuar aplikimi. Faleminderit	21.06.2018 Pershendetje, Nga verifikimi I kryer ne regjistrin tregtar rezulton se, aplikimi juaj per depozitimin e pasqyrave financiare eshte refuzuar me arsyen se: administratorit te shoqerise I ka perfunduar afati me date 31.01.2018. Per sa me siper lutemi te paraqiteni prane sporteleve te Qkb-se , per kryerjen e aplikimit per rinovimin e afatit te administratorit te shoqerise. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
231	21.06.2018	Jam e interesuar per te hapur nje License me aktivitet Zhytje dhe aktivitetet sportive ne uje, por do te doja nje informacion me te detajuar ne lidhje me Licensen qe duhet te pajisem tek QKL, si edhe cfare dokumentacioni kerkohet nga ana juaj. Ju faleminderit, pres pergjigje nga ana jua.	21.06.2018 Pershendetje, Referuar kerkeses tuaj ju bejme me dije se, aktiviteti per te cilin kerkoni te licencoheni, nuk kalon nga /ose nepermjete Qendres Kombetare te Licencimit. Nga QKB-ja ,pajisen me leje peshkimi vetem aktiviteti : Peshkimi dhe forma te tjera te shfrytezimit te faunes ujore te eger- peshkim profesional ne det, kategoria : III.5.A.a.1 , e shtojces se ligjit nr.10081. date 23.02.2018 “Per lejet dhe licencat ne Republiken e Shqiperise”. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
232	21.06.2018	Pershendetje, jam I interesuar te hap nje license per tregeti makinash, cfare dokumentash duhen dhe si Duhet te procedoj	21.06.2018 Pershendetje, Bashkelidhur po ju dergojme dokumentacionin qe duhet te pergatisni per tu pajisur me licencen: Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove te rja ose te perdorura. Pasi te keni pergatitur dokumentacionin duhet te beni aplikim prane sporteleve te Qkb-se, ne Tirane ose ne rrethin tuaj. Per cdo paqartesi na kontaktoni ose mund te vizitoni edhe faqen tone te internetit www.qkb.gov.al	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

233	21.06.2018	Ju lutem cfare dok duhen per te pezulluar aktivitetin e nje shpk	25.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju informojme se, per kryerjen e aplikimit per pezullim aktiviteti te shoqerise, duhet te depozitoni prane sporteleve te QKB-se vendimin e asamblese se ortakeve ose nje kerkese nga administratori I shoqerise, si dhe autorizimin nese aplikimi nuk kryhet nga administratori I shoqerise.	Perfunduar	Nuk ka
234	25.06.2018	Pershendetje Bashkia Skrapar kerkon te paiset me Licence "Per sherbime te kujdesit shoqeror, nenkategoria sherbime te kujdesit ditor" desha te pyes se cfare dokumentash me duhen per tu paisur me kete licence.	27.06.2018 Pershendetje, Bashkelidhur po ju dergojme doumentacioni qe duhet te plotesoni per tu pajisur me licencen :Sherbime te perkujdesit komunitar. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
235	27.06.2018	Ju lutem mund te me informoni se cilat jane procedurat per mbylljen e NIPT-it sekondar per sh.p.k?	27.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj iu informojme se, per te kryer aplikim per mbyllje adrese dytesore duhet te paraqiteni prane sportelave te QKB-se, duke depozituar dokumentacionin perkates, konkretisht: 1. Vendimin e Asamblese se ortakeve ose kerkese nga administrator I shoqerise; 2. Autorizim nese aplikimi nuk kryhet nga administratori I shoqerise. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
236	27.06.2018	Pershendetje,kam bere nje aplikim per cregjistrim te niptit ne ermrin tim ne fund te muajit Maj 2018 , mund te di ju lutem ne cfare faze eshte ?	27.06.2018 pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj iu informojme se, aplikimi juaj eshte ne statusin: " cregjistrim ne pritje", per shkak se ende nuk eshte plotesuar afati prej 30 ditesh, pasi ju keni aplikuar me date 31.05.2018, gjithashtu ju bejme me dije se, nuk jane paraqitur shkresat nga organet tatimore, ku konfirmohet nese jeni debitor ne keto organe apo jo. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

237	27.06.2018	Kerkoj informacion ne lidhje me licensen K 46801211N, emri Luftar Hyseni, Avokat. kerkohet nje kopje e ekstratit te kesaj license.	27.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj iu bejme me dije se, referuar nenit 67, te ligjit nr. 9723/2007, "Per regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, cdo person, kundrejte pageses se tarifes perkatese, ka te drejte te marre pa pengesa, ne format shkresor apo elektronik, sipas deshires ekstrakte per te dhenat e regjistruara te cdo subjekti, si dhe kopje te dokumenteve shoqeruese, te depozituara ne regjister. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
238	27.06.2018	kemi lene nje njoftim per kreditorët dt 21.06.2018 dhe akoma nuk eshte ju lutem nqs ka ndonje problem faleminderit	28.06.2018 Pershendetje, Nga verifikimi I kryer rezulton se njoftimi juaj eshte publikuar ne faqen zyrtare http://www.qkb.gov.al me date 21.06.2018. Verifikimin mund ta kryeni ne faqen zyrtare http://www.qkb.gov.al konkretisht, ne rubriken shpallje dhe njoftim per kreditorët. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
239	28.06.2018	Ju lutem mund te me informoni cilat jane pasqyrat financiare qe duhen dorezuar prane qkb brenda dates 31.07.2018 dhe cilat jane hapat qe duhet te ndjek? Pune te mbare.	29.06.2018 Pershendetje, Mbështetur në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit” i ndryshuar, neni 43, pika (a) subjektet që kanë detyrimin të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, kur mbajtja e tyre është e detyrueshme, detyrohen në çdo rast t’i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar. Detyrimin për depozitimin e dokumenteve të sipërcituara e kanë subjektet që janë regjistruar me përgjegjësi tatimore tatim fitimi, të cilët duhet të dorëzojnë pranë QKB-së: • Pasqyrat financiare vjetore të skanuara ne format PDF; • Raportin e auditimit dhe ecurisë së veprimtarisë (kur mbajtja e tyre është e detyrueshme); • Vendimin për miratimin e pasqyrave financiare (sipas kërkesave ligjore). Afati i fundit i dorëzimit është data 31 Korrik 2018	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

240	29.06.2018	CN-836386-06-18, kam aplikuar per cregjistrim dhe akoma nuk eshte pasqyruar te ekstrakti historik. Cfare procedura te tjera duhet te kryej. Duhet te bej deklarime te tatimet apo njesia vendore, apo i dergoni Ju. Faleminderit	29.06.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj iu bejme me dije se, aplikimi juaj per cregjistrim biznesi eshte ne statusin " cregjistrim ne pritje". Aplikimi juaj eshte kryer me date 26.06.2018, referuar dispozitave ligjore ne fuqi afati maksimal i konfirmimit nga ana e organeve tatimore eshte 30 dite. Subjektet e regjistruara pranë Qendrës Kombëtare tëBiznesit ose gjykatës çregjistrohen pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore të papaguara. Per sa me siper ju bejme me dije se, duhet te prisni afatin 30 ditor, dhe nese nuk keni shlyer detyrimet, ti shlyeni ato ne perputhje me kerkesat e ligjit ne fuqi, me qellim cregjistrimin tuaj nga regjistri tregtar. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
241	29.06.2018	Ju Lutem me ndihmoni ne lidhje me passwordet per subjekt NIPT :K36518202U, Subjektet kane ndryshuar ekonomist dhe nuk gjendet passwordet per depozitimin e pasqyrave financiare te vitit 2017 prane QKB.	02.07.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj iu bejme me dije se lidhur me passwordin per depozitimin e pasqyrave financiare nepermjet portalit e-Albania, lutemi te drejtoheni prane Agjensise Kombetare te Shoqerise se Informacionit (AKSHI), ose mund te dergoni nje email ne adresen login@e-albania.al Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
242	02.07.2018	Kompania qe perfaqesoj do qe te beje nje aplikim prane QKB per perditesimin e te dhenave te administratores se kompanise. Administratorja e kompanise eshte martuar dhe ka marre mbiemrin e bashkeshortit. Martesa eshte kryer ne Austri. Per te bere aplikimin na eshte kerkuar per vertetimin e marrjes se mbiemrit pervec pashaportes edhe certifikata e marteses. Duke qene se procedura per te terheqjen e kësaj certificate me apostile merr nje kohe relativisht te gjate dhe pengon procedura te tjera deklarimi qe kompania do qe te beje prane QKB, a eshte e mundur qe ne vend te certifikates te sjellim nje deklarate noteriale te bashkeshorteve ku pohojne vazhdimin e marredhenies se marteses te mbeshtetur nga nje certificate martese me e vjeter ne kohe	02.07.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj iu infomojme se, lidhur me kerkesen tuaj, duhet te paraqitni prane sporteleve te QKB-se nje akt zyrtar te legalizuar sipas dispozitave ligjore ne fuqi, qe verteton te dhenen e ndryshuar (mbiemrin). Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

243	02.07.2018	Pershendetje .Kerkoj informacion te plote ne lidhje me statusin e kerkeses LC-9722-06-2018 aplikimi eshte bere me dat 18 dhe eshte here e trete e aplikimit.Problematika ka qe 3 muaj. Faleminderit	02.07.2018 Pershendetje, Nga verifikimi ne regjistrin kombetar te leje/ licencave, aplikimi juaj me numer LC-9722-06-2018, eshte me statusin "Institucionin tjetër ne proces".Ky afat perfundon ne daten 18.07.2018. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
244	02.07.2018	Pershendetje Per te marr leje (license) per tregtim pjese kembimi automjetesh cfardokumentacioni duhet. Falemnderit	02.07.2018 Pershendetje, Bashkelidhur po ju dergojme nje kopje te dokumentacionit qe duhet te pergatisni , per tu pajisur me licencen : Tregtimi i pjeseve te kembimit te mjeteve rrugore me motot.Kodi VII.3.B3	Perfunduar	Nuk ka
245	02.07.2018	Kam bere depozitimin e pasqyrave financiare me numer ceshtje CN-841550-06-18 dhe nuk me ka ardhur konfirmimi miratimi nga ana juaj . Shikoj dhe ekstraktin dhe nuk me eshte pasqyruar ende . Ju kutem ma konfirmoni arsyen ?	03.07.2018 Pershendetje, Nga verifikimi I kryer ne regjistrin tregtar rezulton se aplikimi juaj per depozitimin e pasqyrave financiare te vitit 2017 eshte refuzuar me arsyen se: <i>Aplikimi refuzohet: Bazuar ne nenin 26/3 te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, mungon autorizimi per aplikantin.</i> Per sa me siper lutemi te riaplikoni serisht duke depozituar edhe autorizimin per aplikantin. <i>Faleminderit.</i>	Perfunduar	Nuk ka
246	03.07.2018	Pershendetje 1 . Aplikim nr. 842226-06-18 paraqitur ne date 29.06.2018 rezulton ende ne proces regjistrimi. 2. aplikim nr. 833667-06-18 paraqitur ne date 25.06.2018 rezulton pezulluar me vendim por nuk eshte paraqitur asnje aresye e shprehur.	Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj iu bejme me dije se nga verifikimi I kryer ne regjistrin tregtar, aplikimet me nr.842226-06-18 paraqitur ne date 29.06.2018 dhe me nr. 833667-06-18 paraqitur ne date 25.06.2018, rezultojne te miratuara. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

247	03.07.2018	Pershendetje Subjekti Altin Hoxha me Nipt L71420501J ka aplikuar per marjen e Licences per tregti makina te perdorura me 01.06.2018 me nr LC-9363-06-2018.Akoma dhe sot kur kerkojme per satusin e ceshtjes na del Institucion Tjeter-Ne proces Ju lutemi te interesoheni ne cfaze eshte ky aplikim.	03.07.2018 Pershendetje Z.Altin, Afati i vendimarrjes per aplikimin tuaj eshte 4 dite ne QKB dhe 15 dite pune- Institucioni tjeter. Ju keni aplikuar ne daten 01.06.2018. Aplikimi juaj eshte kaluar ne institucionin tjeter - Ministria e Infrastruktures dhe Energjise , per vendimarrje ne daten 08.06.2018.Licenca juaj eshte licence e grupit te trete(Sipas percaktimeve te ligjit Nr.10081 date 23.02.2009) dhe si e tille ka nevojte per inspektim, verifikim te metejshem.Per kete arsye i kalon institucionit tjeter kompetent per vendimarrje. Afati qe ka perllogaritur sistemi per dhenien e vendimit eshte 02.07.2018.	Perfunduar	Nuk ka
248	03.07.2018	Pershendetje Me dt 14. 05.2018 subjketi me nr NIPTI L61605053G ka bere kerkese per mbyllje aktiviteti , ju lutem me thoni statusin e aplikimit.	03.07.2018 Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se subjekti me NUIS (NIPT) L61605053G është Çregjistruar. Verifikimi mund të kryhet në faqen zyrtare www.qkb.gov.al . Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
249	03.07.2018	Pershendetje, Ne lidhje me aplikimin LC-9112-05-2018 per leje mjedisore, shoh ne faqen tua online qe eshte aprovuar. Ju lutem si mund te marr nje kopje te skanuar nga sistemi	03.07.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj iu bejme me dije se mund te paraqiteni prane sporteleve te sherbimeve te QKB-se per te terhequr titullin e licences ose mund te aplikoni nepermjet portalit e-Albania per ta marre ate me nenshkrim elektronik. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

250	03.07.2018	Pershendetje, po ne subjektet qe kemi kaluar tani me TVSH, duhet te deklarojme pasqyrat financiare ne qkb?	04.07.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju informojme si me poshte vijon: Mbështetur në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit” i ndryshuar, neni 43, pika (a) subjektet që kanë detyrimin të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, kur mbajtja e tyre është e detyrueshme, detyrohen në çdo rast t’i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar. Detyrimin për depozitimin e dokumenteve të sipërcituara e kanë subjektet që janë regjistruar me përgjegjësi tatimore tatim fitimi	Perfunduar	Nuk ka
251	04.07.2018	kemi kerkuar para 3 ditesh sqarime per fjalekalimet e shoqerive Xhireton shpk dh NDP shpk Pergjigja juaj ishte se dp te meren pinonjeisit tuaj por akoma asgje. Ndofta nuk kam derguar edhe NIPT atehere Xhireton shpk J71909005P dhe NDP K32408606c Lutemi shpejtoni ne sqarimin pse nuk kalojne fjalekalimet qe ju na i keni derguar.. Per deri sa keni shpallur kete adrese per sqarime lutemi shpejtoni se koha kalon	05.07.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj iu informojme si me poshte vijon: QKB, është një organ administrativ, i cili sipas funksioneve të parashikuara në ligj, përkatësisht neni 4 i Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, parashikon ndër të tjera se, ka këto funksione: a) mban regjistrin tregtar; b) kryen regjistrimet në regjistrin tregtar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji; c) kryen regjistrimin e subjekteve, të përcaktuara në këtë ligj, për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe inspektimit të marrëdhënieve të punës etj. Ç) leshon certifikata, ekstrakte te regjistrimeve dhe kopjeve te vertetuara te akteve d) publikon te dhenat e regjistrit te mbajtur, si dhe siguron aksesin e lire te publikut ne to; dh) informon dhe keshillon per procedurat e regjistrimit Per sa me siper, lidhur me kerkesen tuaj lutemi te drejtoheni prane Agjensise se Shoqerise se informacionit (AKSHI) ose mund te dergoni email ne adresen: login@e-albania.al, pasi nuk eshte ne kompetencat e QKB-se kerkesa juaj. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
252	05.07.2018	Ceshtja eshte hapur qe ne date 27/06/2018 dhe nuk kam marr ende pergjigje afati 24 ore ka kaluar . CN-838968-06-18	05.07.2018 Pershendetje, Nga verifikimi I kryer ne regjistrin tregtar rezulton se aplikimi juaj eshte miratuar. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

253	05.07.2018	Me nevojitet nje informacion se si mund te pajisem me NIPT sekondar per kamion/trailer, cfare te dhenash duhet te vendos te kerkesa per NIPT sekondar, Ju lutem me duhet nje pergjigje sa me shpejt	05.07.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj iu bejme me dije se per te kryer aplikim per nipt sekondar ju duhet te depozitoni prane QKB-se kerkese nga administrator I shoqerise ose vendimin e asamblese se ortakeve si dhe autorizim nese aplikimi nuk kryhet nga administrator I shoqerise. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
254	05.07.2018	Ju lutem me udhezoni se si mund ta siguroi bazen e te dhenave te bizneseve te te gjithë llojeve nga Shqiperia	05.07.2018 Lutemi beni nje percaktim te kerkeses tuaj, me sakte, me qellim qe QKb te mund tiu ofroj informacionin e duhur, si dhe te percaktoje tarifen per sherbimin dytesor te ofruar	Perfunduar	Nuk ka
255	05.07.2018	Pershendetje, Me duhet te dorezoj njoftimin e kreditoreve dhe debitoreve ne lidhje me nje shoqeri qe ka shpallur falimentin. Me kane thene qe njoftimi dorezohet online ne faqen e QKB mirepo nuk po arrij te gjej rubriken ku duhet te regjistrohëm per dorezimin e njoftimit. Ju lutem me ndihmoni duke me orientuar qe te gjej rubriken ku duhet te dorezoj njoftimin. Faleminderit.	07.07.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju informojme se njoftimin per kreditorët mund ta dergoni me poste ose mund ta paraqisni dorazi prane sporteleve te sherbimeve (reception) te QKB-se. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
256	07.07.2018	Pershendetje, Une punoj ne nje organizate jo qevirate por me nevojitet te printoj nje ekstrakt qkr..Por ne momentin qe vendos niptin me thote "Nuk u gjet asnje rezultat" Ka ndonje problem faqia apo per organizatat joqerivater nuk gjenerohet ekstrakti online ?	09.07.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj iu informojme se OJF nuk regjistrohen prane QKB-se, lidhur me kerkesen tuaj, lutemi drejtohuni prane organeve tatimore. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

257	09.07.2018	Kam nevojë për informacion në lidhje me licencat që ju pajisni subjektet në lidhje me aktivitetin servis dhe shitblerje të makinave	10.07.2018 Pershendetje, Referuar kërkesës tuaj ju bejme me dije se, aktiviteti për të cilin kerkoni të licencoheni, përfshihet në kategorinë VII.3.B.1 : Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, të shtojcës 1 VKM-se Nr.538 datë 23.06.2009 dhe kalon nga /ose nëpërmjet Qendres Kombëtare të Biznesit. Aplikimi bëhet në një të vetëm për të treja nënkategoritë. Bashkelidhur po ju dërgoj kriteret që duhet të plotësoni për tu pajisur me këtë licencë..	Perfunduar	Nuk ka
258	10.07.2018	Pershendetje,doja të dija nëse ekziston një listë me emrat dhe nipteve të bizneseve për të bërë kontrollin nëse subjekti është aktiv ose pasiv,nëse kjo listë është e aksesueshme për tu shkarkuar në excel. ju falemnderoj. në pritje të përgjigjes suaj. Gjithë të mirat.	12.07.2018 Pershendetje, Në përgjigje të emailit tuaj ju informojmë se të gjitha të dhënat e regjistruara pranë Qendres Kombëtare të Biznesit janë të publikuara në faqen zyrtare http://www.qkb.gov.al , dhe janë të aksesueshme për të gjithë. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
259	12.07.2018	Pershendetje, Me dt.09.07.2018,kemi bërë online aplikimin për depozitim bilanci të shoqërisë G.E.I.S. ALBANIA SHPK,por nuk kemi asnjë përgjigje në e-mail për pranim ose jo të kësaj kryerje. Ndaj ju lutemi na konfirmoni si paraqitet situata	12.07.2018 Pershendetje, Nga verifikimi i kryer në regjistrin tregtar rezultoi se aplikimi juaj për depozitimin e pasqyrave financiare është miratuar. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
260	12.07.2018	Pershendetje,për nevojën statistikore kërkoj Raport mbi regjistrimet e reja të subjekteve për periudhën Maj-Qershor 2018. Raporti mbi regjistrimet e kërkoj të shoqëruar me NIPT-in përkatës për cdo Shoqëri. Nderkohe bashkelidhur në këtë email po ju dërgoj mandat-pagesën për pagesën e kryer nga unë personalisht, në llogarinë e QKB-së për këtë shërbim.	13.07.2018 Pershendetje, Lutem të gjeni bashkelidhur të dhënat e kërkuara. Punë të mbare! Faleminderit!	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

261	13.07.2018	Pershendetje, Doja te dija neqoftese duhet te pajisen me nipt sekondar mjetet ne pronesi te subjektit te cilat perdoren vetem per te cuar punonjesit neper pune dhe mund te mbajne mjetet e punes brenda. Pune te mbare !	16.07.2018 Përsëndetje, në përgjigje të pyetjes tuaj, sqarojmë se: Qendra Kombëtare e Biznesit, është një organ publik, veprimtaria e së cilit rregullohet në bazë të ligjit nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Konkretisht, në nenit 3, të tij, parashikohet se QKB kryen regjistrimet në regjistrin tregtar, publikon të dhënat e regjistruara, si dhe informon personat e interesuar lidhur me procedurat e regjistrimit si dhe të dhënat e regjistruara pranë regjistrin tregtar. Në nenin 43, pika d, të ligjit nr. 9723/2007, 'Për regjistrimin e biznesit', i ndryshuar, parashikohet se vndet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia; përbëjnë një të dhënë të detyrueshme, për regjistrim. Ju faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
262	16.07.2018	Per regjistrimin e nje SHPK vetem statut dhe akt themelimi duhen, pervec atyre qe jane shenuar ne faqen tuaj. Keto akte (statut dhe akt themelimi) duhet detyrimisht te noterizohen	17.07.2018 Pershendetje, lidhur me pyetjen tuaj sqarojme se bazuar ne nenin 28, pika 3 e ligjit nr. 9723/2007, "Per regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, per regjistrimin fillestar te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, duhet te depozitoni: aplikimin per regjistrimin fillestar, te plotesuar me te gjitha te dhenat e detyrueshme sipas ketij ligji, statutin dhe aktin e themelimit(kur jane hartuar si dy dokumente te vecanta). Nderkohe, sqarojme se akti i themelimit dhe statuti, nuk kerkohen te jene te noterizuara. Ju bejme me dije se, bazuar ne piken 5, te dispozites se sipercituar, ne rast se kerkoni te regjistroni nje dege te shoqerise se huaj, duhet te keni parasysh se duhet te depozitohen aktet e shoqerise meme, te cilat duhet te jene te legalizuara dhe apostiluara sipas ligjeve ne fuqi. Ju faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
263	17.07.2018	Pershendetje! Kam nje pyetje ne lidhje me ndryshim kontrate. kampania ka aplikuar ne QKB per nipt magazine ne hapjen e saj. Tani ne kontrate eshte bere nje ndryshim vetem per siperfaqen e ambienti, por perseri magazina eshte tek e njejta adrese. Duhet ne kete rast te paraqitem ne KB per aplikim?	19.07.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te kerkeses suaj per informacion sqarojme se prane QKB, bazuar ne nenin 43 te Ligjit nr. 9723, date 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, I ndryshuar subjektet tregtare regjistrojne te dhena lidhur me vendet e tjera te ushtrimit te aktivitetit te ndryshme nga selia. Subjektet regjistrojne adresen e ushtrimit te aktivitetit. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

264	19.07.2018	Sot morem nje imeil me permbajtje nuk eshte pranuar aplikimi juaj ne lidhje me depozitimin e bilanc kont 2017. Provojm ta hapim per te lexuar kushtet e refuzimit dhe nuk hapet. Ju lutemi si te veprojmë	19.07.2018 Pershendetje, Ne lidhje me arsyet e refuzimit te aplikimit, pervec se aksesimit ne portalin e –Albania mund ti gjeni edhe ne portalin e Qendres Kombetare te Biznesit ne linkun e meposhtem, ku mjafton te vendosni Case number-in tuaj dhe ju shfaqet vendimi I refuzimit. http://www.qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-statusin-e-aplikimit-te-subjektit/ Per cdo problematike tjeter mos hezitoni te kontaktoni perseri	Perfunduar	Nuk ka
265	22.07.2018	Pershendetje dua qe te hap biznes te vogel, qa kushtetsh duhet plotesuar dhe sa shkon shuma per ti bere me qkb e me kase fiskale.	23.07.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju informojme se per te regjistruar prane QKB-se biznesin tuaj me forme ligjore "person fizik", ju duhet te paraqiteni prane sporteleve te sherbimit te QKB-se, per te kryer aplikim per regjistrimin e biznesit duke depozituar dokumentacionin perkates, konkretisht, dokumentin e identifikimit. Lidhur me kasen fiskale lutemi te drejtoheni prane organeve tatimore, me qellim informimin tuaj sa me sakte. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
266	23.07.2018	Pershendetje! Jemi shoqeria Mantovani-Beton MB shpk per dorezimin e pasyrave financiare emaili i refuzimit eshte i pershkruar si me posht por nuk dalin arsyet e refuzimit	24.07.2018 Pershendetje, Lidhur me kerkesen tuaj ju informojme se, nga verifikimi i kryer ne regjistrin tregtar rezulton se, aplikimi juaj per depozitimin e pasqyrave financiare eshte refuzuar per shkak se mungon dokumenti autorizimit per aplikantin. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

267	24.07.2018	Përsëritje! Në kuadër të monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “ Për të drejtën e Informimit ”, pranë institucionit tonë ka mbërritur një kërkesë për informacion për të cilën do të dëshiroja të kisha bashkëpunimin Tuaj, duke qënë se fusha e përgjegjësisë është Juaja. Lutem për trajtimin e saj sa më shpejt të jetë e mundur. Kërkesa bashkëlidhur.	24.07.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj, ju informojme si me poshte vijon: Në mbështetje të nenit 22, të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit” i ndryshuar, subjektet që detyrohen të regjistrohen janë: a) subjektet tregtare; b) shoqëritë e thjeshta, sipas dispozitave të Kodit Civil; c) personat fizikë, sipas kuptimit të Kodit Civil, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, që ushtrojnë veprimtari ekonomike apo një profesion të pavarur; ç) zyrtat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare dhe të shoqërive të huaja; d) shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit; dh) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë; e) çdo subjekt tjetër, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKB-së. Për sa më sipër, ju bejme me dije se, organizatat jo fitimprurese nuk detyrohen te regjistrohen prane QKB-se, por regjistrohen prane organeve tatimore ose me vendim gjykate. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
268	24.07.2018	Pershendetje,jam ekonomistja subjektit BLERIM GJETA e pajisur me nipt:L46604002M,lutemi na pajisni me kodin per hapjen e llog biznesit pasi do te ngarkojme pasqyrat financiare te vitit 2017,mbetemi ne pritje te pergjigjes tuaj,flm	25.07.2018 Pershendetje,jam ekonomistja subjektit BLERIM GJETA e pajisur me nipt:L46604002M,lutemi na pajisni me kodin per hapjen e llog biznesit pasi do te ngarkojme pasqyrat financiare te vitit 2017,mbetemi ne pritje te pergjigjes tuaj,flm	Perfunduar	Nuk ka
269	25.07.2018	Pershendetje, kemi aplikuar online per depozitim PF 2017 me te dhenat si me poshte , qe ne dt 20 korrik dhe skemi pergjigje rreth aplikimit	25.07.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju informojme se aplikimi juaj per depozitim e pasqyrave financiare te vitit 2017 eshte refuzar per shkak se pasqyrat financiare nuk jane ne formatin e duhur. Sqarojme se, pasqyrat financiare duhet te jene te skanuara ne format PDF, ku cdo document te ngarkohet si nje document I vetem. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

270	25.07.2018	Ju lutem lexoni dokumentin e bashkengjitur dhe ne piken 1 dhe 2 eshte specifikuar Kerkoj te me vihete ne dispozicion informacioni qe un kerkoj ashtu si ligji e permban. . Faleminderit	25.07.2018 Ne vijim te komunikimit sqarojme se nga verifikimi I kryer ne arkiven e QKB-se nuk rezulton asnje kerkese apo komunikim midis Qendres Kombetare te biznesit dhe perfaqesueseve te shoqerise "Arjana- C" shpk, per vitet 2017-2018. Nderkohe persa I perket pikes se dyte te kerkeses tuaj ju bejme me dije se bazuar ne nenin 61 te ligjit 9723/2007, Per regjistrimin e biznesit", I ndryshuar, cdo e dhene e regjistruar ne regjister nga QKB-ja publikohet ne Buletin e Njoftimeve Zyrtare te Regjistrimit, qe mbahet nga QKB-ja ne format elektronik dhe botohet ne faqen e saj zyrtare te internetit. QKB-ja kryen publikimin ne buletin brenda nje dite nga data e kryerjes se regjistrimit. Per cdo publikim percaktohet qarte data, ne te cilen eshte regjistruar e dhena e publikuar. Per sa me siper lidhur me informacionin qe kerkoni per shoqerine e siper cituar ju informojme se mund ta gjeni ne faqen zyrtare te qkb-se http://www.qkb.gov.al, konkretisht ne rubriken kerko per subject do te vendosni numrin e niptit te subjektit dhe me pas do te shkarkoni ekstraktin historik te tij. http://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/ Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
271	25.07.2018	pershendetje subjektin "Serve and Willi" ka dorezuar PF 2017 ne portalin e-albania me date 21.07.2018 dhe akoma nuk ka dale ne ekstrakt. Nqs ka ndonje problem na thoni ta zgjidhim perpara se te mbaroje afati i dorezimit te PF. FALEMINDERIT	26.07.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju informojme se aplikimi juaj per depozitim e pasqyrave financiare te vitit 2017, eshte refuzuar per shkaka se mungon bilanci dhe akti I miratimit. Lutemi riaplikoni serisht duke depozituar dokumentacionin e plote. Afati I fundit per dorezimin e bilanceve eshte data 31 korrik. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

272	26.07.2018	Jam gazetare me baze ne Kosove, po më duhen emrat e të gjitha kompanive me prejardhje nga Katari që operojnë/investojnë në Shqipëri. A mundeni ju lutem te ma siguron listen e të gjitha biznesve me pronar nga Katari të regjistruara në QKB dhe te ma perciellini ne kete email?	27.07.2018 Qendra Kombëtare e Biznesit, si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin e biznesit në Shqipëri, ofron shërbime funksionale në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi. Me qëllim shkurtimin e kohës së marrjes së informacioneve të administruara dhe disponuara në regjistrin tregtar, konform parashikimeve të ligjit të sipërcituar, QKB, ka krijuar mundësinë e ofrimit të shërbimeve të tjera (dytësore), ndaj çdo individ/ subjekti të interesuar, përkundrejt tarifave përkatëse, të miratuara nga Ministri i Financave. Për përfimin e këtyre shërbimeve, çdo individ/subjekt i interesuar, mund të paraqitet pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, për të depozituar kërkesën, të shoqëruar me mandat-pagesën përkatëse (ku specifikohet arsyeja e kryerjes së pagesës).	Perfunduar	Nuk ka
273	27.07.2018	Pershendetje Kemi dorzuar bilancin per Subjektim Mustafa 2014 L41426006A ne portalin E Albania dhe me ka ardhur vertetimi i kryerjes se aplikimit me nr CN-882782-07-18 me date 25.07.2018 Sot me vjen nje email i refuzimit te dorzimit te bilancit ju lutem kerkojme te informohemi per arsyen e mos pranimit te bilancit	27.07.2018 Pershendetje, Ju bejme me dije se aplikimi juaj eshte refuzuar per shkak se pasqyrat financiare te depozituara ne aplikim nuk jane ne formatin e duhur. Lutemi te riaplikoni serisht, duke depozituar dokumentacionin sipas formatit te duhur, te skanuara ne pdf, ku cdo document ngarkohet si nje document I vetem. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
274	27.07.2018	Kerkoj te dorezoj bilancin per biznesin "Shoqata Poker Club" dhe sa here klikoj te butoni perdor me del qe ka ndodhur nje problem gjate ngarkimit te te dhenave dhe kerkon qe ta riprovoj me vone. Kam dite qe e riprovoj edhe prape nuk eshte zgjidhur dhe me del njesoj	30.07.2018 Pershendetje, Lidhur me kerkesen tuaj, ju bejme me dije se OJF-te nuk regjistrohen prane QKB-se, dhe si rrjedhoje nuk depozitojne pasqyra financiare prane QKB-se. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

275	30.07.2018	Pershendetje kam disa dite qe provoj te bej dorezimin e pasqyrave financiare te shoqerise VEGA Shpk por me del ky meszh Ju keni një ceshtje të hapur në QKB. Ju nuk mund të aplikoni për aq kohë sa keni një cështje të hapur në QKB	31.07.2018 Pershendetje, Nga verifikimi I kryer rezulton se keni nje aplikim te pezulluar. Konkretisht, aplikimi me nr.CN-883581-07-18, pas shqyrtimit nga nepunesi I autorizuar eshte pezulluar me arsyetimin se: Te depozitohet prokura e perfaqesimit te z. Kreshnik Cupi. Per sa me siper duhet te paraqiteni prane sporteleve te QKB-se per te kryer plotesimin e aplikimit te sipercituar. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
276	31.07.2018	Per subjektin GUXIMTAR SHARKA me nipt L54501430U ka aplikuar per cregjistrim ne Maj te 2018 me CN-800420-05-18 Duam te dorezojme Bilancin ne QKB por sistemi thote se keni ceshtje te hapur Ju lutem na ndihmoni qe dorezojme Bilancin e 2017 ne e-albania Faleminderit	01.08.2018 Pershendetje, Nga verifikimi I kryer ne regjistrin tregtar rezulton se aplikimi për cregjistrim biznesi eshte refuzuar me arsyetimin se:<i>QKB nuk mund të cregjistrojë subjektin nëse organi tatimor kompetent ka paraqitur kundërshtime për cregjistrimin e subjektit, ne baze e per zbatim te Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” dhe Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 45. Çështja refuzohet, pasi sipas shkresës nr.11068, date 21.06.2018, ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, subjekti ka detyrime të pashlyera/gjoba apo interesa të papaguara me vlerë 7 000 lekë.</i> Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
277	01.08.2018	Pershendetje, Une me Nipt K97512501I ju shkruaj per te kerkuar arsyen e refuzimit te dorezimit te balanceve dhe pasqyrave financiare. Me dt 30.07.2018 po beja deklarimin dhe pasi gabimisht shtypa tastin Enter ne tastiere nuk me lejoj me te vazhdoja me proceduren. Ne sistem me rezulton e shkruar: Ju keni një ceshtje të hapur në QKB. Ju nuk mund të aplikoni për aq kohë sa keni një cështje të hapur në QKB. Me dt 31.07.2018 u paraqita prane zyres se QKB Lezhe dhe nuk me rezulton asnje ceshtje e hapur dhe nuk morem asnje shpjegim se pse nuk mund te vazhdoj. Ju lutem si mund te vazhdojme sepse sot eshte dhe afati i fundit i aplikimit Ne pritje te nje pergjigjeje	01.08.2018 Pershendetje, Nga verifikimi I kryer ne regjistrin tregtar rezulton se aplikimi juaj I dates 30.07.2018, per depozitim e pasqyrave financiare te vitit 2017, eshte refuzuar me arsyen se mungojne aktet e skanuara. Nderkohe me date 31.07.2018, eshte kryer nje aplikim I dyte per depozitim e pasqyrave financiare, I cili eshte ne shqyrtim nga nepunesi I autorizuar, dhe do shqyrtohet sipas afateve te percaktuara ne dispozitat ne fuqi. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

278	01.08.2018	kerkoj te informohem si behet transferimi I veprimtarise ne QKB nga Prindi Individ tregtar qe del ne pension te antari I familjes individ jo tregtar qe do vazhdoje aktivitetin. Dokumentacioni qe kerkohet ne sportelin e QKB-se per te bere transferimin. Faleminderit	01.08.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj, ju bëjmë me dije se, Qendra Kombëtare e Biznesit është krijuar dhe funksionon mbi bazën e Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Ligji I sipercituar nuk parashikon transferimin e biznesit te subjekteve me forme ligjore "person fizik".Numri unik i identifikimit të subjektit jepet vetëm një herë, në çastin e regjistrimit fillestar dhe është i pandryshueshëm, si dhe nuk u jepet subjekteve të tjera edhe pas çregjistrimit. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
279	01.08.2018	Jam e interesuar per regjistrimin e shitjes se kuotave te nje shpk Cila eshte lista e dokumentave dhe forma ligjore e tyre	03.08.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju informojme se, per te kryer aplikim per shitje kuotash duhet te depozitoni prane sporteleve te sherbimit te QKB-se, kontraten per shitjen e kuotave, noterizimi I se ciles nuk perben kusht, bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi, vendimin e asamblese se ortakeve dhe autorizim nese aplikimi nuk kryhet nga administratori I shoqerise. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
280	03.08.2018	administrator i shoqerise "Latifi" me Nipti J87604610U me seli ne Librazhd. ju informoj se kam tentuar disa here te dergoj pasqyrat financiare prane e-albania, pasi kam marre nje email konfirmimi dhe pastaj nje email refuzimi me pas .Me daten 30 masdite kam marre njoftimin dhe jam ndodhur jashte Librazhdit, kur sportelet e qkb kane qe te mbyllura per shkak te mbarimit zyrtar, ditën nesërme ne mengjes me 31 Korrik kam dorezuar vendimin e asamblese per kohezgjatjen e mandatit te administratorit. Kam kryer veprimin kundrejt tarifës shtetërore dhe është hapur ceshtja me Nr.CN-895054-07-18 . Gjithashtu po ne ate moment kam dorezuar vendimin e ansamblese per zgjatjen e afatit te administratorit. Ceshtja ne accountin tim te e- albania ka qene e hapur	06.08.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju bejme me dije si me poshte vijon: Bazuar ne nenin 55, te ligjit 9723/2007, "per regjistrimin e biznesit", I ndryshuar,QKB-ja, pasi kryen verifikimet perkatese, sipas nenit 54 te ketij ligji dhe veren permbushjen e kushteve per regjistrim, kryen regjistrimin ne regjister dhe leshon certifikaten e regjistrimit, Brenda nje afati prej nje dite nga data e paraqitjes se aplikimit. Gjithashtu, bazuar ne piken 37, ne VKM 391/2017, "Per percaktimin e procedurave te regjistrimit dhe publikimit ne Qendren Kombetare te Biznesit" Nese nepunesi I autorizuar I (QKB), pas verifikimeve veren se aplikimi eshte ne perputhje me kerkesat e ligjit te regjistrimit te biznesit, miraton aplikimin dhe kryerjen e regjistrimit, jo me vone se 1 dite, nga data e paraqitjes se aplikimit. Nderkohe, nga verifikimi I kryer ne regjistrin tregtar rezulton se, me date 31.07.2018, ora 10:02, eshte kryer aplikimi me nr. CN-895054-07-18,	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

		deri me datën 01-08-2018 dhe nuk me është dhënë mundësia të ridorezohet pasqyrat financiare. Nuk dua të mëndoj se kjo gjë është bërë në mënyrë të qëllimshme që unë të penalizohem. Kërkoj zgjidhje të problemit duke më pranuar pasqyrat financiare.	nga z. Latif Koci, për zgjatjen e afatit të administratorit të shoqërisë "Latifi" me nr. Nipti J87604610U, dhe me datë 01.08.2018, ora 9:58, pas shqyrtimit nga nëpunësi i autorizuar, aplikimi është miratuar. Për sa më sipër sqarojmë se, shqyrtimi dhe miratimi i aplikimit me nr. CN-895054-07-18, nga Z. Latif Koci është kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për regjistrimin e biznesit. Faleminderit,		
281	06.08.2018	Po plotësoj dokumentat për kredi të butë nga Bashkia dhe më duhet një vertetim nga QKB që nuk jam i regjistruar	07.08.2018 Përsëritje, Në përgjigje të emailit tuaj, ju bëjmë me dije se, bazuar në dispozitat në fuqi, QKB, nuk leshon vertetime, por leshon ekstrakte dhe certifikata regjistrimi. Për sa më sipër lutemi të drejtoheni pranë organeve tatimore, aty mund të pajiseni me vertetim që nuk keni biznes. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
282	07.08.2018	Përsëritje, Jam IT në Bashkinë e Kavajës, me kërkesën e Drejtorit të Taksave doja të pyesja neqoftese është e mundur që të mos shfaqet me ajo pjesë e sigurisë ku thotë „NUK JAM ROBOT. Sepse punonjësit tane nuk e kanë të lehtë të shkarkojnë ekstraktin në momentin kur i duhet. Faleminderit	08.08.2018 Përsëritje, Ju informojmë se për arsye të sigurisë kibernetike të faqes së QKB-së dhe shmangien e ngarkesës së faqes së web-it nga proceset automatike është vendosur kjo masë sigurie dhe nuk mund të hiqet. Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

283	08.08.2018	Pershendetje!Me duhet nje informacion lidhur me kushtet dhe dokumentacionin qe nevojitet per te hapur nje biznes qe ka te beje me prodhimin e integratoreve ushqimor(suplementeve ushqimore) dhe produkteve kozmetike.	10.08.2018 Pershendetje, Referuar kerkeses tuaj ,ju bejme me dije se: Aktiviteti per prodhimin e integratoreve ushqimor(suplementeve ushqimore) dhe produkteve kozmetike, nuk perfshihet ne asnje nga kategorite qe kane nevojte per licence(Referuar shtojces se Ligjit Nr.10081 date 23.02.2009 ”Per licencat dhe autorizimet dhe Lejet ne Republiken e Shqiperise”. Aktiviteti juaj , mund te kete nevojte per leje mjedisore. Per nje informacion me te detajuar referojuni ligjit sektorial Nr. 60/2014 “Per nje ndryshim ne ligjin Nr.10448 date 14.07.2011”Per lejet e Mjedisit. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
284	10.08.2018	Kerkojme nga ana juaj te behet crregjistrimi i biznesit te vogel me NIPT L31418505E, pasi ne sistemin online te tatimeve del qe kerkesa nga ky institucion eshte percjelle prane jush, detyrimet ne kohe reale te biznesit jane zero. Bashkangjitur do te gjeni keto dokumenta.	13.08.2018 Pershendetje, Ju bejme me dije se aplikimi juaj per cregjistrim biznesi, u miratua, aktualisht figuroni ne regjistrin tregtar me status: " cregjistruar" Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
285	13.08.2018	Kemi hasur probleme me shkarkimin e ekstrakteve nga faqja juaj. Na del nje pyetesor qe duhet plotesuar per te konfirmuar qe nuk jemi robot pasi e plotesojme sakte dhe del ticket jeshile qe konfirmon qe nuk jemi robot, i japim download serish nuk shkarkohet por del nje shkrim “Solve recaptcha” . E kemi provuar prej 2 ditesh dhe nuk shkarkojme dot.	13.08.2018 Pershendetje, Ju informojme se per arsye te sigurise kibernetike te faqes se QKB-se dhe shmangien e ngarkeses se faqes se web-it nga proceset automatike eshte vendosur kjo mase sigurie dhe nuk mund te hiqet. Faleminderit per mirekuptimin dhe bashkepunimin	Perfunduar	Nuk ka
286	13.08.2018	Bashkengjitur keni nje kerkese per informacion. Iu lutem ktheni pergjigje ne kohen me te shpejte te mundshme	13.08.2018 Pershendetje, Lidhur me informacionin e kerkuar, me poshte jane te dhenat e kerkuara. Subjektet qe kane kaluar nga statusi “Aktiv” ne statusin “Pezulluar”, per periudhen Janar – Korrik 2018:	Perfunduar	Nuk ka
287	13.08.2018	pershendetje kam aplikuar per mbyllje nipti para 4 muaj dhe deri me sot sme ka mare njeri ne telefon asnje shenje..nderkohe ne bashki rezulton i mbyllur ju lutem mund te mar nje pergjigje	15.08.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj, ju bejme me dije se aplikimi juaj per cregjistrim eshte refuzuar, me arsye: QKB nuk mund të çregjistrojë subjektin nëse organi tatimor kompetent ka paraqitur kundërshtime për çregjistrimin e subjektit, ne baze e per zbatim te Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit” dhe Ligjit Nr.9920, datë	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			14.05.2008, "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 45. Çështja refuzohet, pasi sipas shkresës nr.16243/1, datë 27.02.2018, ardhur nga Bashkia Tiranë, subjekti ka detyrime të pashlyera/gjoba apo interesa të papaguara me vlerë 7500 leke. Faleminderit,		
288	15.08.2018	Ju lutem me thoni si mund te bej aplikimin per zmadhim kapitali tek faqja e albania.faleminderit	15.08.2018 Pershendetje, Lidhur me kerkesen tuaj, ju bejme me dije se: Cdo individ, pasi te jete identifikuar elektronikisht, ka te drejte qe ne cilesine e aplikantit apo te personit te autorizuar, te aplikoj apo te kryej prane sportelit elektronik cdo regjistrim apo veprim tjeter, sipas ketij ligji... Ndekohe sqarojme se, veprimet prane sportelit elektronik te QKB-se per te cilat ky ligj kerkon identifikimin elektronik, kryhen nepermjet mjeteve elektronike qe garantojne autenticitetin e orgjines dhe pacenueshmerine e permbajtjes se dokumenteve ne format elektronik, te pakten nepermjet nenshkrimit elektronik te avancuar, sipas percaktimeve te legjislacionit ne fuqi per nenshkrimin elektronik. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
289	15.08.2018	Pershendetje, kam nevojte te gjej NIPTIN e nje subjekti duke u nisur nga emri i tij. Shoqeria quhet V&K shpk dhe tashme eshte e mbyllur. NIPTI me duhet per efekto dokumentash pensioni. Si duhet te veproj? Faleminderit	16.08.2018 Pershendetje, Nga verifikimi I kryer ne regjistrin tregtar duke u bazuar te emri I subjektit si e dhene e vetme kerkimi, rezulton se shoqeria "V&K", nuk figuron e regjistruar prane regjistrat tregtar. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
290	16.08.2018	Dear Reader, Find attached a change of address also sent by regular post. Please contact me in case of questions.	16.08.2018 Dear Mr.Verhage, We would like to inform you that, the initial registration and every other registration is performed through an application at any service window of the NRC throughout the territory of the Republic of Albania, independently from the place of exercising the activity, domicile or headquarters of the applicant. The application for other registrations is submitted by the person authorized to represent the company with third parties or any person authorized by him or her. Kind regards.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

291	16.08.2018	Prej nje jave kemi hasur veshtiresi ne shkarkimin e nje ekstrakti te thjeshte te nje subjekti te ri per biznesin tone. Problemi qendron ne faktin qe duam te verifikojme nese nje subjekt i ri eshte aktiv ose jo, sepse kemi marre penalitet lidhur me kete ceshtje.	16.08.2018 Pershendetje, Ju informojme se per arsye te sigurise kibernetike te faqes se QKB-se dhe shmangien e ngarkeses se faqes se web-it nga proceset automatike eshte vendosur kjo mase sigurie dhe nuk mund te hiqet. Lutemi te ndiqni te gjitha hapat e percaktuara me qellim vijimin me shkarkimin e ekstraktit. Faleminderit per mirekuptimin dhe bashkepunimin	Perfunduar	Nuk ka
292	16.08.2018	Miredirta!Kam bere aplikim per shtese kapitali dhe nuk me mbyllet ceshtja per mosdorezim te pasqyrave financiare viti 2014.Keto pasqyra kane qene detyrim per subjektet me xhiro mbi 8 000 000 leke.Shoqeria qe une konsultoj ka qene me xhiro nden 8 milione. Ju lutem me jepni nje pergjigje	17.08.2018 Pershendetje, Ne vijim te komunikimit sqarojme se, QKB kryen verifikimin e subjekteve qe kanë detyrimin për mbajtjen e pasqyrave financiare vjetore mbi bazën e të dhënave të dërguara në QKB, nga organet tatimore. Per sa me siper, me qellim miratimin e aplikimit lutemi te depozitoni vertetim nga organet tatimore, qe gjate vitit 2015, nuk keni pasur detyrimin per mbajtjen e bilancit te pasqyrave financiare te vitit 2014 . Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
293	18.08.2018	Pershendetje! Me duhet nje deklarate te ardhurash bilanci 2016-2017, ku mund ta marr dhe a mund ta shkarkoj te e-albania? Faleminderit	20.08.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju bejme me dije se, pasqyrat financiare te depozituara nga subjektet, mund ti shkarkoni nga ekstrakti perkates I subjektit. Konkretisht ne linkun: http://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/ . Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
294	20.08.2018	Prsh kam deshire te hap nje biznes te ri me sakte bar jam 25 vjec.Mund te me informoni rreth kushteve dhe procedurave qe do me duhet te ndjek	22.08.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj, ju informojme se per te regjistruar biznes, me forme ligjore "person fizik", ju duhet te paraqiteni prane sporteleve te QKB-se, per kryerjen e aplikimit per "regjistrim biznesi", duke depozituar dokumentin e identifikimit dhe plotesuar formularin e aplikimit (te cilin e merrni ne sportel). Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

295	22.08.2018	Pershendetje Ju lutem gjeni bashkelidhur vendimin per pezullimin nga ana juaj per aplikimin ne fjale. Ju lutem brenda mundesive na sqaroni cfare dokumenti dhe si duhet te sjellim (pa qene nevoja te vijme deri tek sportelet per sqarime) qe te kursejme kohe dhe te mbyllet sa me shpejt aplimi i ceshtjes.	22.08.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju bejme me dije se: Nga verifikimi I kryer prane regjistrat tregtar rezulton se, aplikimi me nr.CN-912521-08-18, i kryer me date 17.08.2018, per shoqerin "Continental group" shpk, me NUIS K01611001B, pas shqyrtimit nga nepunesi i autorizuar eshte pezulluar me arsyen: "Vendimi shprehet per mandatin e administratorit z. Shefqet Jata per nje mandat 3 vjeçar duke filluar nga data 27.08.2018 (date e cila nuk ka ardhur akoma). Per sa me siper ju bejme me dije se, vendimi i depozituar, ne aplikimin me nr.CN-912521-08-18, shprehet se me date 27.08.2018, fillojne efektet e mandatit 3 vjecar per rimerimin e administratorit te shoqerise. Nderkohe sqarojme se, data 27.08.2018, eshte nje date e cila nuk ka ardhur akoma, per kete arsye pezullimi i aplikimit eshte kryer sipas dispozitave ligjore ne fuqi. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
296	22.08.2018	Ju shkruaj ne emer te kompanise "Beata Shpk" per arsye se me ka ardhur nje email nga e-albania ku njofton se kerkesa ime per depozitimin e pasqyra financiare eshte refuzuar nga Qendra Kombetare e Regjistrimit. Ju lutem a mund te na informoni ne lidhje me arsyen e refuzimit.	23.08.2018 Pershendetje, Ne vijim te komunikimit sqarojme se, sic ju kemi bere me dije dhe ne emailin e meposhtem aplikimi juaj eshte refuzuar per shkak se vendimi I ortakeve, shprehet per destinim fitimi dhe jo per miratimin e bilancit. Nderkohe bazuar ne piken e te nenit 81 te ligjit 9901/2008, "Per tregtare dhe shoqerite tregtare" ,I ndryshuar, asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme: e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise. Per sa me siper ju bejme me dije se, refuzimi I aplikimit eshte kryer ne perputhje me kerkesat e ligjit. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

297	23.08.2018	L31412017N A mund te me ndihmoni pse nuk ka dale akoma licensa per kete subjekt	23.08.2018 Perrshendetje, Nga verifikimi ne regjistrin kombetar te leje/licencave, rezulton se aplikimi LC-0416-07-2018 , eshte ne statusin "Institucioni tjeter ne proces". Ne daten 06.08.2018 Ministria e Infrastruktures dhe Energjise ka kerkuar shtyrje afati prej 15 ditesh. Data e fundit per vendimarrje eshte 28.08.2018. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka
298	23.08.2018	Mesazhi i'm not a robot na pengon ne hapjen e ekstraktit historik. Si mund ti hapim pa vonuar me ore te tera	27.08.2018 Pershendetje, Ju informojme se per arsye te sigurise kibernetike te faqes se QKB-se dhe shmangien e ngarkeses se faqes se web-it nga proceset automatike eshte vendosur kjo mase sigurie dhe nuk mund te hiqet. Faleminderit per mirekuptimin dhe bashkepunimin	Perfunduar	Nuk ka
299	27.08.2018	Pershendetje!Kam aplikuar per c'rregjistrim ne janar te ketij viti,por me eshte refuzuar kerkesa pasi kisha detyrime ne tatime.I kam mbyllur detyrimet ne tatime dhe kam bere kerkesen per c'regjistrim edhe atje.Si mundem te kaloj pasiv	27.08.2018 Pershendetje, Nga verifikimi I kryer prane regjistrit tregtar rezulton se aplikimi juaj per cregjistrim biznesi eshte refuzuar, per shkak se figuroni debitore prane organeve tatimore. Lidhur me pretendimin tuaj se I keni shlyer te gjitha detyrimet ndaj organeve tatimore, lutemi te riaplikoni serisht per cregjistrim biznesi, me qellim cregjistrimin tuaj nga regjistri tregtar. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
300	28.08.2018	Pershendetje, Urojme qe ky e-mail t'iu gjeje mire. Kemi bere nje aplikim per ndryshim license per Globex shp date fillim Gushti 2018 Lutem nje info se ne c'faze eshte aplikimi yne	28.08.2018 Pershendetje, Nga verifikimi I kryer prane regjistrit tregtar rezulton se, aplikimi I kryer me date 25.07.2018, per shoqerine "Globex" shpk, me NUIS J91425012T, pas shqyrtimit nga nepunesi I autorizuar, eshte refuzuar me arsyen se: "Aplikimi refuzohet, bazuar ne nenin 57/1 a te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Regjistrimin e Biznesit",i ndryshuar, ku	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			<i>citohet: "Regjistrimi refuzohet kur ... aplikanti nuk plotëson ose ndreq elementet, që pengojnë regjistrimin brenda afatit 21-ditor (afat i përcaktuar nga neni 56 i ligjit të sipërcituar)". Vendimi datë 25.07.2018 duhet të shprehet saktë në lidhje me ndryshimin që kërkohet të bëhet (nëse kërkohet të bëhet ndryshim i adresës kryesore apo adresës dytësore)".</i> Per sa me siper lutemi te kryeni riaplikim duke paraqitur dokumentacionin shoqerues qe verteton te dhenat qe regjistrohen, ne formen e kerkuar. Faleminderit,		
301	28.08.2018	më datë 31.05.2018 kam aplikuar për çregjistrim me numër CN-802583-05-18 dhe nipt L82517401R dhe në statusin e aplikimit shikoj : Çregjistrim ne Pritje DPT . Nuk e kuptoj pse kjo vonesë pasi ne tatime nuk kam detyrime dhe afati pre 30 ditësh ka kalur. Përfundimisht kërktoj çregjistrimin në QKB.	28.08.2018 Pershendetje, Ju bejme me dije se aplikimi juaj per cregjistrim biznesi, u miratua. Aktualisht subjekti Kleand Seitaj figuron me status "I cregjistruar", prane regjistririt tregtar. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
302	28.08.2018	Pershendetje. Ne pergjigjen tuaj me keni thene se jane mbyllur 978 biznese per muajin Qershor 2018, ndersa nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve me eshte derguar nje pergjigje ku me thuhet se jane mbyllur 1348 biznese. A mund te kem nje shpjegim se pse shifrat e juaja nuk pergjigjen me ato te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve	28.08.2018 Pershendetje, Ne vijim te komunikimit telefonik, sqarojme se, Qendra Kombëtare e Biznesit, kryen regjistrimet në regjistrin tregtar, bazuar në aplikimet e kryera nga subjektet që detyrohen të regjistrohen, në përputhje me nenin 22 të ligjit. Nderkohet, në nenin 40, të ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në administratën tatimore regjistrohen personat juridikë, fizikë dhe individët e mëposhtëm: personat, “të vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi ambulant”, “kryefamiljari, që punëson persona si punëtorë shtëpie”, si dhe organizatat jo fitimprurese. Per sa me siper sqarojme se, sistemi tatimor eshte I ndryshem nga sistemi I regjistririt tregtar. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

303	28.08.2018	Pershendetje, me nevojitet ndihma juaj ne lidhje me cregjistrimin e deges se nje shoqerie te huaj, me proceduren e likuidimit te thjeshtuar. Vendimin e ortakut te vetem te shoqerise ne fjale,vendim ne te cilin deklarom se miraton fillimin e procedures per likuidim te thjeshtuar sipas legjislacionit duke qene se nuk ka detyrime ndaj kreditorëve dhe punonjesve, e solla ne QKB, por me kthyen mbrapsht dhe me thane se duhet ta coj ne gjykate dhe me pas Vendimin e gjykates ta dorezoj ne QKB. Per kete pjese nuk jam e qarte dhe kam nevojë per informacion. Cfare dokumentash duhen pervec vendimit te ortakut te vetem, per te bere kerkesen ne gjykate? A ka ndonje udhezim te vecante per kete procedure?	30.08.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te kerkeses suaj per informacion lidhur me likuidimin e thjeshtezuar te shoqerise, ju bejme me dije si me poshte vijon: Procedura per likuidimin e thjeshtuar, parashikohen ne nenin 204, te Ligjit nr. 9901/2008, “Pwr tregtare dhe shoqerite tregtare”. Konkretisht, ne kete dispozite parashikohet se: <i>1. Shoqëria tregtare mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët apo aksionarët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.</i> <i>2. Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.</i> Ju faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
304	30.08.2018	Pershendetje, per te aplikuar per pezullimin e nje shoqerie SH.A. cilat dokumenta jane te nevojshme per tu sjelle nga na shoerise?	30.08.2018 Pershendetje, Per te bere aplikimin per Pezullim te perkohshem te NIPT duhet te paraqitni dokumentat listen e te cilave e gjeni bashkengjitur ketij email. Me respekt	Perfunduar	Nuk ka
305	30.08.2018	Pershendetje Kam aplikuar per cregjistrim Per cfare arsye nuk po cregjistrohem kur afati 30 dite eshte plotesuar dhe te gjitha detyrimet i kam paguar Faleminderit per mirekuptimin. Nipti: L52118062K	31.08.2018 Pershendetje , Aplikimi juaj me numer CN-870416-07-2018 per cregjistrimin e NIPT L52118062K rezulton te jete ne status Aprovuar. Lutemi paraqituni prane cfaredo sporteli QKB per te terhequr certifikaten e cregjistrimit. Me respekt	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

306	31.08.2018	person fizik me NIPT L52428014E do doja te kisha nga ju ju lutem nje informacion te detajuar ne lidhje me hapat dhe proceduren qe duhet te ndjek per te kaluar statusin nga aktiv ne pasiv.	03.09.2018 Pershendetje, Bashkengjitur ketij email gjeni dokumentat qe duhet te paraqitni ne QKB per "Pezullim NIPT" dhe "Cregjistrim NIPT" per subjektet te regjistruar si "Person Fizik". Per sa I takon pyetjes per detyrimet tatimore per te patur nje pergjigje zyrtare lutemi drejtohuni Organeve Tatimore. Me respect	Perfunduar	Nuk ka
307	03.09.2018	Pershendetje! A mund te me jepni informacion si mund te hap nje license per kurse profesionale? Per kurset si: Guzhinier, anglisht, italisht, gjermanisht, frengjisht. Grafik designe, menaxhim marketingu, it system, parukeri, etj. Dua te di cfare rruge duhet te ndjek dhe cfare dokumentash me duhen per te hapur nje qender per kurse te formimit profesional.	03.09.2018 Pershendetje, Bashkelidhur gjeni dokumentacionin per tu pajisur me licencen : Formim Profesional, kategoria X.2.e shtojces se ligjit 10081 date 23.02.2009. Per tu pajisur me kete licence duhet te jeni fillimisht te regjistruar si biznes ne regjistrin tregtar , ku te keni specifikuar ne fushen e veprimtarise: Kurse te formimit profesional	Perfunduar	Nuk ka
308	03.09.2018	Pershendetje, Ne baze te takimit qe patem ne zyren tuaj il 28/08/2018 kerkoj konferme qe firma jone SOLTECH SHPK nuk ka nevojte per licence mjedisore.	04.09.2018 Në përgjigje të email-it ju informojmë si vijon: Bazuar në Ligjin Nr. 10081, datë 23.02.2009, <i>“Leje është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të përdorë një të mirë publike, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të”</i> . Gjithashtu, në shtojcën e Ligjit Nr. 10081/2009, “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë parashikuar lejet dhe licencat që lëshohen në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, në Aneksin 1 dhe 2, të VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, janë të përcaktuara licencat dhe lejet që si rregull trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe ato që trajtohen pa përfshirjen e QKB-së. Ndër lejet e parashikuara në Aneksin 1, të VKM Nr. 538/2009, janë <i>“Leje mjedisi e tipit A” me kodin III.1.C, “Leje mjedisi e tipit B” me kodin III.1.B dhe “Leje mjedisi e tipit C” me kodin III.1.A</i> . Këto licenca janë konceptuar si licenca të grupit 3 dhe trajtohen nëpërmjet QKB-së, në përputhje me kriteret dhe procedurat e licencimit të parashikuara nga Ligji Nr. 10081/2009 dhe VKM nr. 538/2009. Ligji Nr. 10448, datë 14/07/2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, ka parashikuar sistemin e ri të lejeve të mjedisit. Në shtojcën 1, të këtij ligji	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			parashikohen veprimtaritë që duhet të pajisen me Leje Mjedisi të tipit A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi. Kërkesat e posaçme, dokumentacioni i nevojshëm dhe tarifat përkatëse për Lejet e Mjedisit të Tipit A, B dhe C janë të përcaktuara në VKM Nr. 419, datë 25/06/2014, “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, dhe VKM Nr. 417, datë 25/06/2014, “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”. Për sa më sipër, në rast se veprimtaria e përcaktuar në email-in tuaj, përfshihet në veprimtaritë e shtojcës së Ligjit Nr. 10448/2011, atëherë, subjekti duhet të paraqitet pranë sporteleve të QKB-së për të aplikuar për Leje Mjedisi të tipit A dhe/ose B dhe/ose C në përputhje me kriteret dhe dokumentacionin e përcaktuar në legjislacionin sektorial.		
309	04.09.2018	Po ju shkruaj ne lidhjen me depozitimim e ceshtjes me Nr. CN-921393-08-18, prane zyrave tuaja. Ju lutem a mund te procedoni me shqyrtimin e kesaj ceshtje brenda dites se sotme pasi subjekti duhet te filloje aktivitetin e per pasoje, vonesa ne marrjen e vendimit nga ana e institucionit tuaj do te rezultonte ne dem ekonomik per shoqerine.	06.09.2018 Pershendetje , Ju informojme se aplikimi me numer CN-921393-08-18 eshte miratuar. Me respekt	Perfunduar	Nuk ka
310	06.09.2018	Pershendetje jam punonjese e Njesis Adm. Novosele Vlore me duhet informacion per disa biznese qe ushtrojn aktivitet ne njesin tone por sistemi nuk me lejon te hap ekstratin . Ju lutem si munde te futem ne sistem per keto biznese ? Faleminderit	07.09.2018 Ju informojme se per arsye te sigurise kibernetike te faqes se QKB-se dhe shmangien e ngarkeses se faqes se web-it nga proceset automatike eshte vendosur masa e sigurise Captcha. Fillimisht, per te aksesuar te dhenat e kerkuara duhet te keni akses ne Internet. Ekstraktet historike apo te thjeshte, si dhe dokumentet qe permbahen ne to, mund gjenerohen vetem pasi te keni klikuar “I’m not a robot”, duke ndjekur perzgjedhjen e imazheve vijuese qe kerkohen nga ky funksionalitet	Perfunduar	Nuk ka
311	07.09.2018	Pershendetje , jam e interesuar per aplikimin per licence ne fushen e veprimtarise se autoriparimit.Nese eshte e mundur mund te kem nje informacion se si duhet ta bej kete aplikim.Faleminderit	10.09.2018 Pershendetje , Ligji parashikon licencimin e disa kategorive te lidhura me "Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove" . Kategorite jane si me poshte: • VII.3.B.1 - Blerja shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio • VII.3.B.1 - Mbledhja depozitimi shkaterrimi i mjeteve ose pjeseve te tyre te dala jashte perdorimit apo te braktisura.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			- VII.3.B.1 - Riparimi dhe mirembajtja e gomave të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. - VII.3.B.1 - Riparimi dhe mirembajtja e impiantit elektrik te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. - VII.3.B.1 - Riparimi dhe mirembajtja e karrocere te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. - VII.3.B.1 - Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Per te na mundesuar t'ju japim nje pergjigje sa me te sakte lutemi saktsoni per cilen kategori jeni te interesuar. Me respekt		
312	10.09.2018	Pershendetje Jam e interesuar per te hapur nje biznes Kancelari. Por dua iformacion si te veproj per regjistrimin, taksat qe duhet te paguaj dhe proceduren per deklarimin e malli.	11.09.2018 Pershendetje, Per te regjistruar biznesin ne QKB ju duhet te zgjidhni paraprakisht formen ligjore te administrimit te biznesit tuaj. Bashkengjitur ketij email gjeni dokumentat dhe procedurat per hapjen e nje NIPT si "Person Fizik" dhe / ose "Person Juridik". Per sa I takon pyetjes mbi taksat qe duhen paguar dhe deklarimin e mallit lutemi drejtohuni Oqaneve Tatimore pasi jane ato qe mund t'ju japin nje pergjigje te sakte. Me respekt	Perfunduar	Nuk ka
313	10.09.2018	Une doja me informacion persa i perket pyetjes se meposhtme. Dua te hap ne muajt ne vazhdim nie kompani shpk ne Tirane. Diten e regjistrimit mund te paraqes adresen e shtepise ne tirane per regjistrim deri sa te gjej zyrat ku do kryhet aktiviteti? A do paguhet tatime ne burim per shtepine pavaresisht se ajo nuk do jete zyra ku do kryhet aktiviteti por vetem adresa e korrespondences per javet transitor? Me duhet te parages kontraten e shtepise pavaresisht se kjo nuk do hete zyra aktivitetit?	11.09.2018 regjistrin tregtar, kryhen ne baze te aplikimeve prane cdo sporteli sherbimi, nga personat e autorizuar duke bashkelidhur te gjitha dokumentacionet e kerkuara, referuar dispozitave ligjore ne fuqi. Sqarojme se, cdo e dhene e regjistruar prane regjistrin tregtar, kryhet ne baze te deklarimeve te subjektit dhe akteve te depozituara prej tij, per regjistrin. Nderkohe, ne ligjin organik te QKB-se, nr. 9723, date 03.05.2007, "Per regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, parashikohet pocedura e nevojshme per regjistrimin fillestar te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, te dhenat e detyrueshme si dhe dokumentacioni i kerkuar. Konkretisht, ne nenin 32, te tij parashikohet se si e dhene e detyrueshme, nder te tjera dhe selia e shoqerise. Me regjistrimin fillestar, subjekti pajiset me NUIS dhe nga ky moment fiton personalitet juridik. Gjithashtu, sqarojme se regjistrimi fillestar prane regjistrin tregtar, perben githashtu regjistrim te njekohshem dhe prane administrates tatimore, qendrore dhe vendore, ne skemen e sigurimeve shoqerore e shendetesore dhe prane inspektoriatit te punes.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			Per informacion me te detajuar, mund t'ju vij ne ndihme link-u: http://qkr.gov.al/informacion-mbi-proceduren/regjistri-i-biznesit/regjistrimi-fillestar/ Nderkohe, persa i perket tatimit ne burim, lutemi te drejtoheni prane organeve kompetente perkatese, per trajtimin e kesaj ceshtje		
314	11.09.2018	Dje kam aplikuar prane sporteleve tuaja dhe sot duke kontrolluar statusin me thote qe regjistrimi eshte I paplote. Ju lutem me sqaroni arsyen Pse?	12.09.2018 Pershendetje, Aplikimi me numer CN-933884-09-2018 eshte aprovuar. Me respekt	Perfunduar	Nuk ka
315	11.09.2018	Çeshtja me numer CN-845640-07-18 eshte refuzuar, por ne sistem nuk me del cila eshte arsyeja e refuzimit. Ju lutem me jepni nje pergjigje se cfare hapash duhet te bej per te finalizuar rregjistrimin e SHPK. Faleminderit	13.09.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj, ju bejme me dije se, nga verifikimi I kryer prane regjistrin tregtar rezulton se aplikimi juaj me nr.CN-845640-07-18 , pas shqyrtimit nga nepunesi I autorizuar eshte refuzuar, me arsyen se: "Te saktosohet datelindja e ortakut Shpetim Duqi ne statutin e depozituar. Te nenshkruhet statuti nga ortakut Shpetim Duqi. Te depozitohet mandati i ketij subjekti. Te depozitohet dokumentacioni shoqerues qe verteton te dhenat e regjistrimit etj, te ortakut Fondacioni "Tourism Investment and Financ Fund"(statut, akt I cili verteton qe ortakut I sipercituar, nuk eshte ne process falimentimi, si dhe vendimet). Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
316	13.09.2018	Ju lutem do donim te dinim cilat jane proceuarat per mbylljen e Niptit sekondar te firmes iu lutem? A duhet te paraqitem une si administrator apo lejohet dhe nje person i autorizuar?	13.09.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju bejme me dije se, per te kryer mbylljen e nje adrese sekondare, duhet te kryeni aplikim prane sporteleve te sherbimit te QKB-se, si dhe te depozitoni vendimin e asamblese se ortakeve, ose nje kerkese nga administrator i shoqerise si dhe autorizim nese aplikimi nuk kryhet nga administratori i shoqerise. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

317	13.09.2018	Asmida shpk, nipt: k79631401K.Arsyeja eshte per riaplikim leje shfrytezimi 10-vjeçare. Kemi ardhur disa here per aplikim ne QKB edhe na eshte thene se nuk mundeni te apikoni .. ju lutem nje sqarim per situaten, faleminderit	14.09.2018 Pershendetje, Qendra Kombëtare e Biznesit me anë të shkresës 8575/1, datë 03.08.2018 ka vënë në dijeni subjektin ASMIDA lidhur me pergjigjen e kthyer Ministrise së Infrastrukturës dhe Energjisë. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
318	14.09.2018	Jemi paisur me Leje Mjedisore te Tipit C me Numer serial: PN-7102-09-2018 dhe duhet te revokojne lejen egzistuese te Tipit B. Per revokimin e lejes egzistuese me Numer serjal: PN-5916-07-2013, i kemi bere shkrese Agjensise Kombetare te Mjedisit dhe ne pergjigje te tyre citohet qe bazuar ne ligjin Nr.10448 dt.14.7.2011 i ndryshuar, veprimet per revokim duhet te kalojne nepermjet QKB. (shkersen do ta gjeni ne attach) Nga ana tjeter, kemi bere kerkese per revokimin e Lejes Mjedisore Tipi B, prane QKB Elbasan, dhe kerkesa jone eshte refuzuar me arsyen qe revokimin duhet te miratohet nga Ministri, bazuar ne te njejtin ligj,Nr.10448 dt.14.07.2011 i ndryshuar. (shkersen do ta gjeni ne attach) Aktualisht Doalpaint Shpk eshte e paisur me dy Leje Mjedisore njera e Tipit B dhe njera e Tipit C. Ju lutem me thoni si te veproji per te bere Revokimin e Lejes Mjedisore Tipi B. Ne pritje te pergjigjes! Dite te mbare!	17.09.2018 Pershendetje, Nga verifikimi në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve rezultoi që aplikimi për revokimin e lejes mjedisore me PN-5916-07-2013 është refuzuar me arsyet e mëposhtme: Kërkesa e subjekteve për heqjen dorë pjesërisht/tërësisht ose revokimin e Lejes së Mjedisit të tipit A, B dhe C përkatëse, duhet të miratohet nga Ministri apo agjencia përkatëse rajonale e mjedisit, sipas rastit.Baza ligjore Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Neni 26 “Heqja dorë nga leja e mjedisit”. Ligji Nr. 10081, datë 23/02/2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, Neni 29, “Revokimi i licencës/autorizimit/lejes pika 1. “Titujt e lëshuar, sipas këtij kreu, revokohen sipas parashikimeve në legjisllacionin në fuqi”. Në nenin 26, të Ligjit 10448, datë 14, 07,2011, përcaktohet heqja dorë nga leja e mjedisit të tipit A, B dhe C. Heqja dorë nga leja e mjedisit 1. Operatori i një veprimtarie, subjekt i një lejeje mjedisi të tipave A, B ose C, sipas përcaktimit të këtij ligji, mund të bëjë një kërkesë në QKL për heqjen dorë, pjesërisht apo plotësisht, nga leja e mjedisit. 2. Ministri apo agjencia përkatëse rajonale e mjedisit, sipas rastit, miratojnë heqjen dorë, pjesërisht apo plotësisht, nga leja e mjedisit, në qoftë se vlerësojnë se operatori ka marrë masat e nevojshme: a) për të shmangur një rrezik ndotjeje nga veprimtaria e instalimit; b) për të kthyer territorin e veprimtarisë në gjendje të kënaqshme, duke pasur parasysh gjendjen e këtij territori para se instalimi të fillonte veprimtarinë. 3. Ministria apo ARM-ja i përcjell QKB-së vendimin e miratimit të heqjes dorë nga leja e mjedisit. Faleminderit	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

319	17.09.2018	Ju lutem nje pyetje per menyren si do veprohet Ka vdekur ortak i vetem i nje shoqerie,cfare procedure do ndjekim qe kjo shoqeri te vazhdoje normalisht aktivitetin ku bashkeshortja eshte administratore ,por duhet te jete dhe ortake mbas kesaj ngjarje. Faleminderit	17.09.2018 Pershendetje, Ne vijim te komunikimit lidhur me kerkesen tuaj, sqarojme se, bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen ose kalohen nepermjet: a) kontributit ne kapitalin e shoqerise; b) shitblerjes; c) trashëgimise ; d) dhurimit; e) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj. Per sa me siper ju bejme me dije se bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi, duhet te kryhet celja e deshmise se trashëgimise. Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
320	17.09.2018	Kam nevojë për një Informacion. dua të hap një shoqëri. pyetja është nëse mund të paraqes kerkesen per regjistrim prane QKB një javë pas firmosjes së Aktit të Themelimit dhe Statutit apo duhet në të njëjtën ditë	18.09.2018 Pershendetje, Ne përgjigje të emailit tuaj ju bejme me dije se, bazuar në nenin 22 të ligjit 9723/2007, subjektet, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligjet e posacme, aplikojnë për regjistrim fillestar si më poshtë: b) personat juridik, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e themelimit, por në cdo rast përpara datës së nisjes efektive të veprimtarisë. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
321	18.09.2018	Pershendetje,une interesohem se si dhe cfar duhet te beje nje shtetas i huaj per te hapur nje biznes individual ose kompani kolektive,cilat jane hapat qe duhet te ndjeke per tu bere e mundeshme hapja e ketij biznesi?cfar dokumentacionesh duhet te disponoj ose grumbulloj?pune te mbare.	19.09.2018 Pershendetje, Ne përgjigje të emailit tuaj ju bejme me dije si më poshtë vijon: Bazuar në dispozitat e ligjit 9723/2007, personat fizik regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, si dhe një kopje të dokumentit të identifikimit. Nderkohe ju informojmë se, shoqëritë kolektive , komandite dhe ato me përgjegjësi të kufizuar mund të regjistrohen gjithashtu, duke depozituar vetëm aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, dokumentet e identifikimit të antareve apo ortakëve dhe duke nënshkruar deklaratën e posacme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, për organizimin dhe funksionimin e llojit të shoqërisë që regjistrohet. Në këtë rast, aplikimi për regjistrim fillestar dhe deklarata e mesipërme, e nënshkruar sipas	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			rastit nga ortaket, antaret ose nga personat e autorizuar te veprojnë ne emer e per llogari te tyre, zvendeson aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise. Faleminderit,		
322	19.09.2018	Po Ju dergoj kete ankese ne lidhje me venien e gjobes per subjektin ARB, pasi jane dorezuar si pasqyrat financiare dhe Vendimi i asamblese brenda afatit ligjor, Shpresoj qe kjo ankese do merret parasysh.	20.09.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj, bejme me dije se, pas shqyrtimit te pretendimeve tuaja dhe verifikimeve perkatese, lutemi te riaplikoni per depozitim te pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2017, pa penalitetin perkates. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
323	20.09.2018	pershendetje, dje bera aplikimin per te regjistruar biznesin dhe sot mora pergjigjen per pezullim te aplikimit sepse emri ishte i zene. Kisha nje pyetje per emrin e ri qe mund te gjejme a ka problem qe ne regjistrin kombetar te biznesit te jete me emer tjeter nga ajo qe do te operojme ne treg?	20.09.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju bejme me dije se, bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi, ndalohet regjistrimi ne regjistrin tregtar I subjekteve me emra te njejte ose te ngjashem, me emra ne trajten e shquar apo shkurtimet perkatese te shteteve, qyteteve, krahinave gjeografike, organizatave nderkombetare, fetare ose institucioneve te pushtetit qendror apo vendor, pa shtesa dalluese ose me emera, qe jane ne kundershtrim me rendin e moralin public apo me dispozitat urdheruese te ligjit. Nderkohe bejme me dije se bazuar ne nenin 44 te ligjit Nr. 9723/2007, Subjektet mund te regjistrojne cdo te dhene tjeter, te ndryshme nga te dhenat e percaktuara ne nenin 43 te ketij ligji, te cilat kane lidhje me veprimtarine e tyre. Keto te dhena shtese perfshijne por pa u kufizuar ne to: a) emertimin ose shenjat e tjera dalluese te veprimtarise (nese eshte/jane te ndryshme nga emeri I regjistruar I subjektit). Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

324	20.09.2018	jam bashkë-administator i kompanisë Premium Berry shpk me numër NIPT L72512405A, me qendër në Levan, Fier. Nga faqja online e QKB jam përpjekur të shkarkoj Statutin e kompanisë por më rezultoi që në arkivën online të QKB disa faqe mungojnë nga ky dokument. Kërkoj ndihmën tuaj dhe orientim si mund ta zgjidh këtë çështje dhe të marr një kopje të plotë të këtij dokumenti nga arkiva e QKB.	21.09.2018 Pershendetje, Ne përgjigje te emailit tuaj ju bejme me dije se, lidhur me kerkesen tuaj, lutemi te paraqiteni prane sporteleve te sherbimit te QKb-se, ku do te plotesoni formularin per terheqjen e kopjeve te vertetuara te akteve, dhe brenda nje afati prej 1 jave ju pajiseni me dokumentacionin e kerkuar, te njehesuar me orgjinalin	Perfunduar	Nuk ka
325	21.09.2018	jam Doktorante prane Fakultetit Ekonomise dheAgrobiznesit, Universiteti Bujqesor iTiranes. Bashkengjitur iu kam nisur nje kerkese lidhur me dhenen e nje liste me NIPT e kompanive te regjistruara ne Republiken e Shqiperise, qe do me sherbej si popullate per nxjerrjen e nje kampioni per kryerjen e kerkimit tim shkencor te doktorates me titull "Procesi i rritjes dh nderkombetarizimit te NVM-ve Shqiptare dhe faktoret e brendshem qe ndikojne.	24.09.2018 Pershendetje Bashkelidhur gjeni informacionin e kerkuar, te dhena per subjektet me status aktiv, duke perjashtuar te dhenat per personat fizik sic rame dakort nepermjet komunikimit telefonik. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
326	24.09.2018	me shese pak aksione nga nje subjekt privat ku edhe un jam aksioner. Lutemi si duhet te veprojm? Flm ne pritje te nje pergjigje tuaj te shpejte dhe pozitive ju uroj dite te mbare.	24.09.2018 Pershendetje, Ne përgjigje te emailit tuaj ju bejme me dije se: Në bazë të nenit 73, të Ligjit 9901, datë 24.04.2008, kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: Kontributit në kapitalin e shoqërisë; Shitblerjes; Trashëgimisë; Dhurimit; Cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Për sa më sipër, për të bërë të mundur, kalimin, transferimin,apo shitjen e kuotave së një shoqërie, duhet të depozitohet akti i kalimit të pronësisë sipas nenit 73 të sipërcituar. Akti i kalimit të pronësisë, duhet të paraqitet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, neni 162 e në vijim, dhe regjistrohet, sipas nenit 43, të Ligjit nr. 9723, date 03.05.2007, “Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit”. Konkretisht për kryerjen e aplikimit për shitje kuotash prane sporteleve te sherbimit te QKB-se depozitohet vendimi I asamblese se ortakeve si dhe kontrata per shitjen e kuotave, noterizimi i se ciles nuk perben kusht per regjistrim.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			Faleminderit,		
327	24.09.2018	Po nese nje kompani e huaj do te hapi nje filial ne shqiperi, si eshte procedura?	25.09.2018 Në mbështetje të nenit 28 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji si dhe: a) aktin e themelimit e statutin e shoqërisë së huaj, kur këto janë dy dokumente të veçanta apo, në mungesë, aktin ekuivalent të krijimit, sipas legjislacionit të huaj, si dhe tekstin e plotë të tyre me ndryshimet e mëpasshme; b) dokumentacionin, që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në juridiksionin e huaj; c) dokumentacionin, që vërteton gjendjen aktuale të shoqërisë së huaj, të lëshuar brenda një afati jo më shumë se 90 ditë nga data e aplikimit, me të dhënat e regjistrimit dhe të përfaqësimit, përfshirë informacionin nëse është në proces likuidimi apo falimentimi; ç) bilancin e shoqërisë së huaj për vitin e fundit financiar, mbajtur sipas standardeve të kërkuara në shtetin e huaj, nëse shoqëria e huaj ka pasur veprimtari për më shumë se një vit; d) vendimin ose aktet e tjera të organit përkatës të shoqërisë së huaj, sipas legjislacionit të huaj për hapjen e degës ose të zyrës së përfaqësimit. Aktet e kësaj pike zëvendësohen nga aplikimi për regjistrim në rastin kur personi, që kërkon regjistrimin, është njëkohësisht organi përgjegjës për të vepruar i vetëm, në emër të shoqërisë së huaj. Per informacion me te detajuar ju mund te klikoni ne faqen tone zyrtare www.qkb.gov.al	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

328	24.09.2018	Pershendetje! Jam e interesuar per te hapur nje agjensi turistike. Doja te dija sa kushton licenca per nje binzes te tille dhe si jane procedurat per te hapur nje biznes te till!	25.09.2018 Ju duhet të regjistroheni paraprakisht pranë sporteleve të QKB-së për tu pajisur me NUIS (NIPT) si subjekt. Më pas mund të vazhdoni procedurat për licencim duke plotësuar listën e dokumentave për licencën me kodin XIII.1.A për "Agjenci Udhëtimi" sipas kriterëve bashkëlidhur e-mail-it. Për çdo informacion shtesë ju mund të aksesoni lirisht në faqen tonë zyrtare të internetit www.qkb.gov.al ose të drejtoheni pranë zyrave të informacionit në QKB. Punë të mbarë.	Perfunduar	Nuk ka
329	25.09.2018	Pershendetje. Ju lutem doja te dija nese eshte e nevojshme per hapjen e nje biznesi, qendre kursesh per femije, licenca nga QKL apo mjafton aplikimi ne QKB? Faleminderit!	27.09.2018 Përshëndetje, Subjektet që kryejnë veprimtari në ofrimin e kurseve të formimit profesional licencohen sipas licencës me kodin X.2.B. Ju duhet të aplikoni për licencë pranë QKB-së duke paraqitur dokumentat sipas listës së kriterëve bashkëlidhur. Për çdo informacion shtesë ju mund të aksesoni lirisht në faqen tonë zyrtare të internetit www.qkb.gov.al ose të drejtoheni pranë zyrave të informacionit në QKB. Punë të mbarë.	Perfunduar	Nuk ka
330	25.09.2018	Pershendetje, vendimi i ortakut per ndryshim, deri ne cfare afati mund te depozitohet ne qkb	27.09.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju bejme me dije se bazuar ne nenin 22 te ligjit 9723/2007, per regjistrimet e tjera te detyrueshme, pervec rasteve kur ky ligj percakton ndryshe, aplikimi behet brenda 30 diteve kalendarike nga data e ngjarjes se rrethanes faktike dhe/ose e hartimit te aktit te detyrueshem per tu regjistruar. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
331	27.09.2018	Jemi nje firme Belge qe desherojme te hapim nje zyre perfaqesie ne Shqiperi, Cfare dokumentash na nevojiten per tu regjistruar ne QKB dhe per te zhvilluar aktivitetin tone edhe ne Shqiperi	27.09.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju informojme si me poshte vijon: Bazuar ne dispozitat ligjore ne ligjin Nr.9723/2007, degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji si dhe: a) aktin e themelimit e statutin e shoqërisë së huaj, kur këto janë dy dokumente të veçanta apo, në mungesë, aktin ekuivalent të krijimit, sipas legjislacionit të huaj, si dhe tekstin e plotë të tyre me ndryshimet e mëpasshme; b) dokumentacionin, që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në juridiksionin e huaj; c) dokumentacionin, që vërteton gjendjen aktuale të shoqërisë së huaj, të	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

			lëshuar brenda një afati jo më shumë se 90 ditë nga data e aplikimit, me të dhënat e regjistrimit dhe të përfaqësimit, përfshirë informacionin nëse është në proces likuidimi apo falimentimi; ç) bilancin e shoqërisë së huaj për vitin e fundit financiar, mbajtur sipas standardeve të kërkuara në shtetin e huaj, nëse shoqëria e huaj ka pasur veprimtari për më shumë se një vit; d) vendimin ose aktet e tjera të organit përkatës të shoqërisë së huaj, sipas legjislacionit të huaj për hapjen e degës ose të zyrës së përfaqësimit. Aktet e kësaj pike zëvendësohen nga aplikimi për regjistrim në rastin kur personi, që kërkon regjistrimin, është njëkohësisht organi përgjegjës për të vepruar i vetëm, në emër të shoqërisë së huaj. 6. Shoqëritë dhe unionet e kursim-kredisë, si dhe shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë regjistrohen duke depozituar në regjistrin tregtar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, statutin dhe aktin e themelimit, në rast se janë hartuar si dy dokumente të veçanta, si dhe çdo dokument tjetër, të kërkuar sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu ju bejme me dije se, dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe. Së bashku me dokumentin shoqërues në shqip, aplikanti mund të depozitojë edhe përkthimin e vërtetuar në gjuhë të huaj. Aktet private dhe dokumentet zyrtare të juridiksioneve të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe dhe të legalizohen sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Faleminderit.		
332	27.09.2018	Jemi nje subjekt i organizuar ne forme SHPK, me xhiro deri 8 milion 8e vogel), me pronar te vetem. Dua te di a mund ta ndryshoj formen e organizimit nga SHPK ne Person Fizik? Nese po cfare duhet te bejme?	27.09.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju bejme me dije se, kalimi nga forma ligjore "person juridik" ne formen ligjore "person fizik" nuk parashikohet ne ligjin nr.9723/2007, "Per regjistrimin e biznesit", I ndryshuar. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
333	27.09.2018	pse nuk hapen ekstraktet e thjeshta te operateveve ekonomik, me qellim verifikimet e tyre nese jane objekt i veprimtarise se procedurave te prokurimit	27.09.2018 Pershendetje, Ju informojme se per arsye te sigurise kibernetike te faqes se QKB-se dhe shmangien e ngarkeses se faqes se web-it nga proceset automatike eshte vendosur kjo mase sigurie dhe nuk mund te hiqet. Faleminderit per mirekuptimin dhe bashkepunimin. Per shkarkimin e ekstraktit lutemi te ndiqni te gjitha hapat e percaktuara ne faqen zyrtare http://www.qkb.gov.al Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

334	27.09.2018	Ju lutemi, mund te me ndihmoni me proceduren qe duhet te ndjek per mbylljen e 1 biznesi SHPK , Ju bej me dije se biznesi ka 1 vit qe eshte I pezulluar, dhe tani duam te bejme mbylljen e tij .	27.09.2018 Pershendetje, Ne pergjigje te emailit tuaj ju informojme si me poshte vijon: Bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi, aplikimi per cregjistrimin e Personit Juridik behet ne 2 faza: a) Faza e parë (Fillimi i procedurës së likuidimit) Në nenet 190-205, të Ligjit Nr. 9901.14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, përcaktohet në këtë fazë depozitohet vendimi i asamblesë së shoqërisë, i cili duhet të shprehet për fillimin e procedurës së likuidimit dhe caktimin e një likuidatori. Aplikimi kryhet nga likuidatori ose çdo person i autorizuar nga likuidatori. Likuidatori duhet të paraqes dhe një deklaratë, në të cilën duhet të shprehet për pranimin e detyrës së ngarkuar si likuidator i shoqërisë. Gjithashtu, neni 195, i Ligjit Nr.9901/2008, përcakton se <i>likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj në internet, nëse ka, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.</i> Konkretisht, pas miratimit të aplikimit të fazës së parë, likuidatori i shoqërisë harton ftesën e parë drejtuar kreditorëve të shoqërisë, të cilën e sjell për publikim në QKB, pas 30 ditësh nga publikimi i ftesës së parë drejtuar kreditorëve, likuidatori sjell në QKB për publikim ftesën e dytë drejtuar kreditorëve , pas 30 ditësh nga publikimi i ftesës së dytë likuidatori aplikon për cregjistrimin e shoqërisë. b) Faza e dytë cregjistrimi i shoqërisë) Në këtë fazë likuidatori i shoqërisë ose çdo person i autorizuar prej tij, sjell për depozitim Bilancin Çelës dhe mbyllës të likuidimit, vendimin e asmblesë së shoqërisë, i cili duhet të shprehet për miratimin e raportit të likuidatorit dhe cregjistrimin e shoqërisë.	Perfunduar	Nuk ka

Regjistri i kërkesave online nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të QKB-së www.qkb.gov.al

335	27.09.2018	Ju lutem jam e interesur te di numrin e Klinikave dhe Studiove Dentare ne republiken e Shqiperise, dhe gjithashtu sa prej tyre ndodhen ne qytetin e Tiranës.	28.09.2018 Pershendetje, Lidhur me licencat e leshuara per klinika e kabinete stomatologjike bej me dije se jane 1367 ne total me status Aktive, ku 604 prej tyre jane ne Bashkine Tirane. Faleminderit,	Perfunduar	Nuk ka
336	28.09.2018	Subjekti "Vision" me nr. kerkese LC-9058-05-2018, ka aplikuar per license dhe MFE e ka miratuar kete kerkese. Per arsye shendetesore subjekti nuk eshte paraqitur brenda afateve ligjore dhe per kete arsye duhet bere riaktivizimi i licenses. Do tju lutesha nese eshte e mundur te me dergoni nr e licenses te ketij subjekti pasi ne nuk e disponojme	28.09.2018 Pershendetje, Nga verifikimi në regjistrin elektronik të Lejeve, Licencave, Autorizimeve, aplikimi me LC-9058-05-2018 datë 22-05-2018 i subjektit VISION me NIPT K61618028U rezulton me licencën e aprovuar me LN-5343-06-2018. Kjo licencë me status "Revokuar". Faleminderit.	Perfunduar	Nuk ka
